

# RUZHDI PULAHA



BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8JH-32

P97

**NUSJA  
e HUMBETIRES**

**novelë**

8JH-32

P 97

RUZHDI PULAHA

# NUSJA E HUMBËTIRËS

Novelë



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»



## I

Fshati ynë duhet të ketë pasur emër tjetër, por atë s'e di askush. Humbëtirë është nofka e tij. Si duket, nëpër kohëra, njerëzit u mësuan me të dhe e harruan emrin e vërtetë, siç u harrohet emri disa njerëzve që ikin nga kjo botë pa lënë asgjë që t'u mbahet mend. Por fshati ynë nuk ishte i tillë. Hasmî, duke mos mundur ta zhdukte dot, i vrau emrin dhe e quajti Humbëtirë. Akoma dhe sot midis brinjave shkëmbore të malit duken rrënojat e një shtëpie të lashtë, nga e cila zuri fill fshati ynë. Thonë se aty qe ngulur një farë Zylyftari. Kishte rënë në gjak për punë uji a për punë gruaje në fshatin e tij dhe erdhi u fsheh këtu, ku dielli të thotë mirëmëngjes në mes të ditës e ku dëborra s'të ndahet gjer në mes të prillit. Zylyftari gërmoi pesë rrogoza vend, sa për të mbajtur frymën dhe s'u duk më nga anët e tij. E harruan të gjithë. E harruan edhe hasmët e tij, dhe thonë se atëherë duhet t'ia kenë ngjitur Zylyftar Humbëtira. Mbiemri i tij i mbeti fshatit si një mallëkim i përhershëm, që i ndoqi brezat njëri pas tjetrit gjer në vitet e luftës.

Se si i vajti filli derës së Zylyftarit, edhe kjo s'dihet. Thonë se një nga pinjollët e tij bëri emër si kaçak, por më pas emri i tyre humbet përsëri. Kanë mbetur vetëm gërmadhat e kullës nën sjetull të malit, përballë Grykës së Zezë, ku era të grin edhe në mes

të korrikut. Por Zylyftari i ruhej plumbit e jo erës. Ndoshta, duke mos pasur me kë të këmbente një fjalë, dilte e fliste me erën. Në këto gryka të egra e ngrysi jetën emërharruari Zylyftar! Pastaj zjarrin e mbajtën ndezur të bijtë e të nipërit, dhe shtëpi pas shtëpie lindi fshati, që, si mënga e një krahu të prerë, filloi të varej poshtë nëpër një luginëz të ngushtë. Por emri Humbëtirë i mbeti. Dhe, sado që pleqtë nuk besojnë, ne duhet të jemi nga gjaku i atij Zylyftarit, që hasmi e përzuri nga fshati i tij, dhe ai mori me vete një thëngjill dhe hapi vatër të re këtu, në fole të ujque.

Që kur erdha në mendtë e mia, fshati ynë kishte njëzet e nëntë shtëpi, as më shumë e as më pak. Edhe babai im thoshte se kaq kishte gjetur. Njerëzit shtoheshin, po shtëpitë mbeteshin njëzet e nëntë, veçse zmadhoheshin e merrnin ca forma të çuditshme, duke shtuar mur pas muri konakët e ulët me gurë dhe u ngjanin më shumë ca gazermave të çrregullta, sesa shtëpive. Tokën s'e matnin me dynymë, po me pëllëmbë, dhe buka që bënin, s'u dilte as për tre muaj, po Humbëtira kishte marrë nam për mushkat e për dhitë e, më të keq se me të keq, po e nxirrte njëfarësoj bukën e motit. Disa herë i kishin vënë fshatit emra të rinj, por ata lindnin e vdisnin aty, dhe të tjerët e thërritnin gjithnjë Humbëtirë, e shikonin me sy të lig e si me përçmim. Fshati më i afërt mbante katër orë të shëndosha, kurse qyteti një ditë rrugë. Dhe falë atij zakoni të keq, që e shiste vajzën, se zor të merrte njeri nuse në Humbëtirë. Ato shkonin në ca fshatra më të këputura se ky yni, por që, fundja, e kishin një emër. Baballarët i shitnin çupat pothuaj falas e, kur i martonin, u jepnin kuverta të dhirta e nga dy mushka. Megjithatë nga çdo brez mbeteshin nga tri e



nga katër vajza pa martuar. Por s'qenë të paktë edhe djemtë që ishin plakur beqarë, ndonëse nuset i blenin shtrenjtë, sa qimet e kokës.

Kurse mua më doli fati pa mbushur mirë të shtatëmbëdhjetat, më shpejt nga ç'e pritja unë dhe të tjerët. . .

Ishte fundi i nëntorit. Babai që pa gdhirë qe nisur me dy mushka për në qytet. Njërës i kishte vënë një barrë djathë e tjetrës i hipi vetë. Nënës i tha të mos e pritnim atë natë. Të nesërmen filloi dëbora. Ai erdhi vonë. Zilet e mushkave i dëgjoi e para Zarja, motra e vogël. Ajo e do shumë babanë dhe që në drekë kish-te ngritur veshët e priste. U vumë në lëvizje të gjithë. Nëna vrapoi të hapte derën e oborrit. Im vëlla, Veliu, vuri kandilin në dritare, që të bënte dritë jash-të, dhe doli me xhaketën krahëve. Unë shkunda urët e zjarrit dhe hodha në vatër një krah me shkarpa të thata. Si shkarkuan barrët, Veliu u fshiu hajvanëve të lodhur kurrizet që lëshonin avull dhe shkoi t'i grazhdonte, duke i mbuluar me nga një shkorsë të leshtë. Babai u dha në derë i përmiellur nga dëbora. Ajo i zbardhte mbi festen e zezë, mbi vetulla, mbi mustaqet e trasha, mbi bërruc. . . kurse çorapet e gjata të dhirta i dukeshin si çizme prej dëbore. Megjithatë nuk dukej aq i lodhur sa e pritnim dhe as që i ra në sy kujdesi ynë për ta pritur sa më mirë, siç e donte nderi e zakoni. Më hodhi një shikim të çuditshëm, që s'e kisha vënë re kurrë në sytë e tij dhe m'u duk sikur një gëzim i fshehtë pikonte nga mjekra e tij e mprehtë bashkë me pikat e ujit të dëborës që po shkrinte.

— Shko foli Zenos të vijë, — i tha nënës, e cila po i shkundte dëborën me fshesë.

Kur ajo po dilte, si gjithmonë me hapin e saj të lehtë, babai i tha të thërriste edhe Belulin. Unë e vë-

reja vjedhtas e m'u mbush mendja se diçka duhej të kishte, që s'i hynte në sy as lodhja e as të ftohtët. Por nga fytyra e tij e ashpër s'mund të kuptoje asgjë. Për të pyetur as që më shkante ndër mend.

I afroi duart zjarrit, i hukati dy tri-herë, pastaj nxori nga hejbetë një bohçe të vogël, ma hodhi në duar e më tha me të butë:

— Na nxirrni ca raki, një mëshere djathë e shkoni matanë.

Zarja e hapi bohçen, nxori që andej një qese të vogël me sheqer e një copë basmë. Hera e parë që babai më blente diçka. Ai u ul këmbëkryq pas vatrës, në qoshen e tij, mbi postiqen e kuqe. Veloja u ul në krahun tjetër, përballë, si për natë.

— Shumë u vonove, — tha Veloja.

— Shpejt jam nisur, po u vonova te mulliri i Dervishëve për misrin.

— Si ta zuri djathin Qakua?

— U grindëm ca, po ma mori si herën e parë... Prapë ma hodhi çifuti i qenit, më hëngri në kandar nja pesë-gjashtë okë.

— Për tjetër të porositi?

— E do vonë, pas nja pesë javësh

Kjo ishte një bisedë e zakonshme, që përsëritej sa herë kthehej babai nga pazari, kurse unë kisha bërë veshët bigë e pritja mos dëgjoja diçka tjetër. Në derë u dha Zenoja, vëllai i madh i babait, e Beluli, një kushëri i tij i parë, po që e mbante për vëlla edhe atë. Babai e Veloja u ngritën e u lëshuan vendin.

— Hajt, matanë ju! — na tha babai mua dhe Zares.

Lëshova midis tyre tepsinë me rakinë e djathin e dola. Zarja më ndoqi pas. Nënja nusëronte më kë-



mbë në mes të konakut dhe priste në do t'i jepte babai ndonjë urdhëratë, apo do t'i thoshte të vinte pas nesh.

— Ulu edhe ti! — dëgjova zërin e tij, ndërsa po mbyllja derën dhe u binda se do të kishte ndodhur diçka jo e zakonshme, derisa mbajtën edhe nënën atje në kuvendin e burrave.

## II

— Epo, hair haber, o byrazer! — tha xhaxhai dhe ngriti gotën.

— Për hair është nisur, o Zeno, — tha babai, i menduar dhe, si e çoku gotën me të tjerët, e ktheu me fund. — Më kërkojnë Belen.

Ata e shikonin në gojë, por ai për një copë herë nuk foli. Mendohej dhe dridhte më nge një cigare me atë duhanin e zi, që e grinte vetë me thikë e që lëshonte një tym të hidhur e djegës, që të merrte frymën. Nënës i bëhej sikur në vend të zemrës kishte një grusht që i godiste brinjët, dhe i dridhej trupi. Kjo ishte krejt e papritur. Dhe s'e kishte parë kurrë të shoqin drejt e në sy si atë natë.

— Ma kërkojnë në Ftonjar, — tha babai, — Nuria i Xhakollarëve, për të birin.

Të tjerët pritnin dhe hiqnin në heshtje cigaret e trasha.

— Ai që erdhi e mori dhitë dy muaj të shkuar e që pimë atë natë sindozot sonte, ja, mu këtu... — desh t'u kujtonte babai.

— E di Nuren, e di, — tha Beluli.

— U poqëm në han. Fjalë e muhabet, e më tha se i qemë dukur njerëz të mirë, se çupa i pëlqente

dhe do dërgonte njeri për ta kërkuar, po, meqë u takuam, ma tha vetë.

Kaq tha babai. Pastaj i ngritën disa herë gotat në heshtje. Nëna i shikonte të gjithë me radhë, si me frikë, se mos i mbushej mendja ndonjërit, thoshte ndonjë fjalë e më prishte fatin.

— Fshat i mirë ftonjari, — tha Beluli. — Bëjnë për tetë-nëntë muaj bereqet ftonjarkët. Kam njohur nja dy asaj ane. Janë namusqarë e qenër të punës.

— Burra të mirë ftonjarkët, — u hodh Zenoja. — Më pëlqeu Nuria atë natë në muhabet. Veç rakisë sikur s'ia thoshte.

— Plak njeri, — ngau muhabetin Beluli. — Pastaj, s'janë mësuar me këtë fonën, të maresë. Andej pinë të kumbullës, të zier dy herë... Ç'njerëz ka?

— Dy djem e tri çupa, — tha Veloja.

— Ky është i vogli, — tha babai. — I thonë Gani. Të tjerët i ka martuar të gjithë.

— Epo, si e ke mendjen? — pyeti xhaxhai.

— Për këtë punë ju thirra, — tha babai. — Nuk e preva fjalën. I thashë Nures të flas një herë me byrazerët.

— Djalin s'e njohim, — tha Beluli.

Nënia u tremb përsëri dhe e mbështolli të kunatin me një shikim lutës.

— Asllan! — tha babai. — E pashë vetë. Ishte në han me t'anë. Një bojalli, vetullkalesh, qimegësh-tenjë. Nga kashta të merrte më qafë. Po edhe syrin e kishte plumb e s'i bënte xhap gjëkund.

— Po hesapi si dukej? — u kujtua xhaxhai.

— Ia zura në gojë, po Nuria ma kaloi si pas krahëve. Më tha se i pëlqente miqësia me derën tonë.



Do dërgojë njeri pas ca ditësh që të marrë fjalën.  
Tani folni ju.

Ata ngritën prapë gotat pa folur dhe u panë sy  
më sy. Xhaxhait, si më i madhi i takonte të fliste i pari.

— Unë them ta japim, Tefik, — tha ai. — Më  
mirë zor se gjejmë.

— Ta japim, — tha edhe Beluli. — Derë e mirë  
Xhakollarët.

— Po ti ç'thua? — pyeti Velon babai.

— Nënia ç'thotë? — tha Veloja.

— Ju i dini këto punë, — tha e druajtur nënia.  
— Kështu si dëgjova, si mirë më duket, ku di unë!

Babai drodhi edhe një cigare tjetër të trashë  
dhe e hoqi nja dy herë thellë. Atij i takonte fjala  
e fundit. Të tjerët pritnin. Priste sidomos nënia  
me zemër të dredhur.

— Mbushi! — i tha babai Velos.

Ai i mbushte me radhë e ua jepte në dorë. Ishin  
gotat e urimit.

— Epo... — tha babai duke ngritur gotën lart  
e duke u hedhur një sy të gjithëve. — Ua dhamë  
Belen Xhakollarëve. Të na trashëgohet!

Të gjithë i pinë gotat me fund, lëvizën nga  
vendi e iu zgjidh gjuha sikur qenë lehtësuar nga  
një barrë e rëndë, që mbanin mbi supe.

Burrat pinë deri vonë. Dikur ia morën dhe kë-  
ngës. Kurse nënia erdhi në konakun tonë. Sytë i për-  
pëliteshin dhe mjekra i dridhej. Mua s'më kishte zë-  
në gjumi dhe pritja, por as që më shkante mendja  
se bisedonin për mua, pinin për mua, këndonin për  
mua. Nënia mundahej të më thoshte diçka, po s'e li-  
nin lotët, që mezi po i mbante. Befas më përqafoi  
dhe më mbuloi fytyrën me të puthura. Buzët e fa-  
qet i digjnin, duart i dridheshin mbi shpatullat e  
mia... Dhe qante.

— Nusja e nënës... Të fejuam! — Zëri i saj ishte i dhimbshëm, i përmallshëm, prekës. M'u duk sikur diçka m'u këput në gjoks dhe ra me zhurmë në thellësitë e mia. Dhe ashtu, nëpër lotë, nëna m'i tregoi të gjitha. Ajo qante nga gazi e nga dhimsuria. Unë nuk e dija nga se.

U shtrimë të flinim. Dikur nënën e zuri gjumi dhe mua më dukej sikur fytyra e saj e vrarë buzëqeshte. Pastaj s'pashë më asgjë. Ajo ishte një natë e gjatë, si një ëndërr pa fund, që më shtypte me ankthin e saj. Herë më dukej se jetoja në boshllëk e më merreshin mendtë e herë sikur mbi mua ishte përmbysur një mal i tërë, nën të cilin mbytesha në djersë, pa mundur të lëvizja as gishtin. Nëpër këtë trazirë më shfaqej si pas mjegullës fytyra e mprehtë e Delos, me ata sytë e hirtë, të ndezur, me një shuk rru-dhash në shtegun e ballit dhe me mjekrën që i dridhej. Kështu më kishte mbetur fytyra e tij pas atij çasti të shkurtër, të papritur e të papërsëritshëm, që e kishte goditur jetën time me një dritë të frikshme...

\*  
\*  
\*

Ne ishim rritur bashkë dhe s'më pat shkuar kurrë nëpër mend se ai mund të më thoshte ato fjalë, që ranë mbi mua si një kazan me ujë të valuar dhe ai shikim i panjohur, që do të linte tek unë një plagë të padukshme, po të përhershme.

Atë mbrëmje u shfaq papritur te gardhi dhe, ndërsa më ndihmonte kokulur për të futur dhitë në ahur, më foli me atë zërin e mekur, që s'ishte zëri i tij:



— Eh, sa e mirë je ti, Bele! Më vjen të pëlças!  
Lum ai që do të të marrë.

Zëri i tij ishte një psherëtimë e thellë. Duke mos gjetur dot forca të përmbahesha, ngrita kokën dhe e pashë. Sytë e tij m'u dukën të lagur. Ai ishte ngurosur. S'kisha parë kurrë djalë të ngrinte kështu para një çupe. Pastaj u shkund, seç desh të thoshte me një lëvizje të dorës në ajër dhe iku duke marrë me vete një hidhërim të madh dhe duke më lënë mua si një dru, pa frymë e pa gjak, që s'lëvizja dot.

— Hë, moj, tundu! S'i ke në ballë, a?

Ishte zëri i babait, që kishte qëndruar me këmbë të hapura te dera dhe më tregonte dhitë, që i ishin sulur mullarit të vogël me misërishte në fund të oborrit.

Kur u kujtova se ai mund t'i kishte dëgjuar fjalët e Delos, më pushtoi ajo ndjenja e veçantë që provon njeriu kur kupton befas se ka shpëtuar nga një rrezik i madh krejt rastësisht.

Me ethet e atij çasti jetova me javë e me muaj, po Delon nuk e pashë më. Ai kishte ikur në mal që atë mbrëmje, duke lënë në sytë e mi portretin e tij të turbullt, por të paharrueshëm dhe ato dy fjalë që, sa herë i kujtoja, më ndizej gjaku e më buçitnin veshët. Ndoshta e teproj, por unë jetoja me habinë e atij njeriu që e di veten të vdekur, dhe dikush i pëshpërit te veshi se është gjallë.

Në Humbëtirën tonë shekujt dhe zakonet e egra e kishin transformuar dashurinë në një qenie të padukshme, por që shfaqej kudo me mungesën e saj, e frikshme. Dukej sikur, duke i hequr emrin, fshatin tonë edhe e kishin mallëkuar: «Mos dashurofsh kurrë!» Ajo trazohej dhe lëvrinte në thellësi të shpirttra-

ve dhe shuhej po aty. Të vetmen fytyrë të dashurisë ne e shihnim në legjendën e kobshme të Nijes, që kishte kaluar kushedi në sa breza.

Nija kishte qenë vajzë e urtë, por dashurinë s'e kishte mbytur dot dhe ishte arratisur me një djalë po nga Humbëtira me shpresë të gjenin strehë gjëkund. Legjenda thotë se atë natë ranë njëqind rrufe dhe grykat ulërinin, sikur të ishin mbledhur aty gjithë ujëqit e botës. Ikja e tyre u mor vesh shpejt. Dhe i ndoqën dhjetë burra të armatosur. Djalin e kishin vrarë. Nija kishte rënë e kishte qarë mbi gjoksin e tij, pastaj ishte lëshuar me vrap si e çmendur. Ata të dhjetë e ndiqnin ta kapnin, por ajo kishte shkarë dhe ishte gremisur nga një shkëmb, që sot e gjithë ditën i thonë shkëmbi i Nijes. Emri i djalit u harrua që atë ditë, dhe ai udhëtonte me legjendën gojë më gojë si «i ligu». Ishin nga një fshat e quheshin motër e vëlla, siç do të më quanin edhe mua me Delon, meqë familjet tona paskan dalë nga një oxhak, paçka se kanë kaluar njëzet e më shumë breza që atëherë. E jetova legjendën atë çast kur Deloja më tha ato fjalët e zjarrta aty te gardhi. E jetova përsëri atë natë kur më thanë se më kishin fejuar dhe unë qaja pa ditur për se. Mbase kam qarë, meqë do të ndahesha nga legjenda e nga kujtimi i atij çasti, me të cilin ishte lidhur gjëja më e bukur e jetës sime.

M'u duk sikur një dorë e butë më përkëdhelte flokët me shumë kujdes që të mos trembesha. Pastaj dëgjova zërin e nënës:

— S'bëre rehat natën, flitje në gjumë, — tha nëna. — Kështu kemi bërë të tëra, po ti mos u mërzit, se do vesh në derë të mirë.

Ngrita kokën dhe e pashë një çast në sytë e saj, që kullonin dashuri nëne.



— Pate fat! — tha prapë ajo me një zë ngushëllues.

Lëshova kokën në gjoksin e saj dhe u shkreha në vaj. Dora e butë shkiste përsëri mbi flokët e mi, dhe doja që ato përkëdhelje të mos mbaronin kurrë, po në dhomën e zjarrit dëgjova babanë që kollitej, dhe nëna u ngrit. Atë ditë edhe ai m'u duk ndryshe, nuk thirri që andej, siç e kishte zakon mëngjeseve, kur ngrihej para nesh:

«Hë, moj, hankot e Zyber agës, hashashi ju ka zënë?!»

Kishte zbardhur. Kjo sikur më lehtësoi. Nata e gjatë me peshën e saj shtypëse kishte kaluar. Nuk do të isha më vetëm. Vetmia më ngjethte.

### III

Kaloi një vit. Një vit i gjatë dhe i vështirë lufte, siç ishte ai. Lufta kishte hyrë në shtëpinë tonë dhe, pa e kuptuar, me jetonim me të. Baballarët e vëllezërit sillnin lajme përditë dhe për luftën flitnin të gjithë.

Njëherë erdhi në fshat një i panjohur, që s'bleu as dhi, as djathë, as mushka, që s'ishte as mysafir e që s'vinte as si mbles. Ishte njeriu i parë i Luftës që pashë. Veshur me një palë rroba shajaku, që i rrinin ngjitur pas trupit e që s'duhet t'i kishte të tijat, dukëj sikur dilte dy pëllëmbë mbi të tjerët. Ishte thantnik e me një fytyrë të vogël, që e tregonte njeri të qeshur e dashamir. Në shtëpinë e Deliut u mblodhën nga një burrë për shtëpi e qëndruan gjer në mes të natës. Ne s'morëm vesh ç'u fol aty dhe burrin e gjatë, veshur me shajak, s'na e zuri më syri, se kishte

ikur nëpër terr, po në Humbëtirë diçka e re filloi të lëvizte që të nesërmen. Dhe akoma s'e kuptonim se luftonte edhe Humbëtira jonë, ndonëse mbledhjet po bëheshin të shpeshta dhe herë pas here njerëz të fshatit mblidhnin shtëpi më shtëpi ku djathë, ku gjizë, ku miell, dhe njëri nga djemtë, me një kafshë a dy, nisej jo rrugës për në qytet, po tutje, nga malet. Dhe nganjëherë humbiste me ditë. Njëherë shkoi edhe im vëlla. Babai theri një dhi, e rropi, e pastroi dhe e futi prapë në lëkurë, pastaj në një thes dhe ia vuri mushkës mbi barrë. Veloja u kthye pas tri ditësh. Unë kisha vendosur t'i lutesha të më tregonte nga kishte qenë e ç'kishte parë andej. Por ai, pa i thënë gjë akoma, më mori mënjanë dhe më tregoi për partizanët. E dëgjoja sikur të fliste për një botë tjetër, për ca njerëz të çuditshëm, që s'i kisha parë kurrë.

— Thonë që ka dhe çupa andej. . .

— Ka, — tha Veloja. — Ka edhe çupa.

— Kushedi si do jenë ato?!

— Ja, kështu, si ti, çupa si tërë çupat e botës.

Si do jenë?

Pa ditur si ta vazhdoja bisedën, heshta një copë herë. Unë s'kisha parë kurrë çupa të veshura si burrat, që mbanin kapelë në kokë e pushkë në krah, që qeshnin tok e hanin tok, që luftonin sup më sup, që flinin jashtë, midis tyre, që ata i merrnin në krahë kur plagoseshin, apo kur kapërcenin lumenjtë. . .

Veliu më shihte me buzë në gaz dhe mua m'u duk sikur më qortonte për atë që pata menduar.

— Ato s'janë çupa si tërë çupat, jo. . . o! Janë më të mirat.

Ai sikur i përtypte fjalët, dhe unë, duke parë sytë e tij të menduar, kuptova se i vinte keq për mua.



— Do të vijmë nja dy prej tyre edhe këtej nga ne, që t'ju futin edhe ju në Lëvizje, — tha Veliu.

— Ku na lënë ne? — buzëqesha hidhur. — Le që ku jemi ne për ato punë! Babai s'do të të linte ty, që je djalë e jo mua.

— Punët e luftës janë të ngatërruara... ca janë të hapura, po ca janë të fshehta, që s'mund t'ia thuash as babait e as nënës.

— Po ti je në Lëvizje? — e pyeta me ankth.

— Këto gjëra nuk tregohen, po ty po ta them. Jam edhe unë.

— Po djem të tjerë nga fshati ynë, ka?

— E teprove tani. Mos pyet kaq shumë dhe, për ato që të thashë, mos i trego njeriu, — tha Veliu dhe iku.

Ishte e para herë që më kërkonin të ruaja një të fshehtë. Kjo më mbushte me një ndjenjë të paprovuar, që më ngazëllente. Veliu po rritej papritur në sytë e mi, dhe unë sikur jetoja nën hijen e tij.

Mbas dy javësh, me barrën e ushqimeve, shkuan dy djem të tjerë nga fshati dhe s'u kthyen, po mua s'më mbushej mendja të qenë vërtet partizanë. «Shumë-shumë, — thosha me vete, — mund t'u ndihmojnë partizanëve të ngarkojnë hajvanët apo të merren me ndonjë punë tjetër, se partizanët s'janë si këta djem-të e Humbëtirës». Kështu mendonin dhe shoqet e mia. Nuk kishim faj. Në fshatin tonë një mik të vinte dhe mbahej mend gjashtë muaj. Ishim të papara, të padala, të lëna larg kuvendeve të burrave. Shumë gjëra s'i kuptonim e mundoheshim t'i merrnim me mend, po, kuptohet, ç'hamendje mund të kishte një vajzë që kishte parë vetëm male, mushka, dhi e që babai i fliste vetëm kur e urdhëronte. Por lufta ishte një lumë i çuditshëm, që rridhte më të poshtë e më të lart, gjer atje, në Humbëtirën tonë.

Një mëngjes fshati u gdhi i rrethuar. Na zgjuan qentë, që filluan të lehnin si të tërbuar. Pastaj krisi pushka, që s'rreshti ndonjë gjysmë orë. S'kishim dëgjuar kurrë kaq shumë pushkë dhe kaq pranë. Flija me nënën dhe me motrën. Shikonim njëra-tjetrën të hutuara dhe heshtim. Gjermanët e ballistët, si duket, e kuptuan që s'kishte partizanë dhe hynë në fshat me armët në gjoks e duke shtirë në erë. Kishin sy të egër e të ligj gjermanët e më dukeshin të gjithë vëngëroshë. Kur flitnin, më dukej sikur thyenin arra me dhëmbë. Rrija me gjak të ngrirë dhe pritja ç'do të ndodhte. S'lanë gjë pa përmbysur. Pastaj shanë dreqi e di se si dhe, kur ikën, morën dhe Kuqen, mushkën trevjeçare që do ta shpija prikë në derë të burrit. M'u duk sikur më shkulën diçka prej trupit. Mushka ishte e vetmja qenie e gjallë aty, që më kujtonte dasmën. Unë shkoja shpesh në ahur, e përkëdhelja e i mërmëritja, as unë s'e di se çfarë, sikur të qanim hallin për atë ditë që na afrohej gjithnjë, kur do të niseshim të dyja për në Ftonjarin e panjohur. Veloja u zverdh e turfullonte dhe njëherë s'u përmbajt e u sul t'ia rrëmbente gjermanit kapistrën nga dora, po babai e përfshiu për krahu dhe e hoqi mënjanë. Veloja u shkëput i zemëruar nga duart e babait dhe pështyu gjermanin, por ai s'e pa dhe u largua.

— Budalla! — shau babai. — Kjo është trimëri budallai! Ikën kot, për dhjamë qeni!

Babai atë çast m'u duk si një pus, ku molla e Adamit ngjitej e zbriste si një kovë që nxirrte duf parreshtur. Nëna ishte shastisur. Unë isha bërë dru. Velon s'e mbante vendi.

Gjermanët ikën, pasi e kthyen fshatin përmbys. Vranë Salikon, që e gjetën me armë dhe dogjën shtë-



pitë e atyre dy djemve që ishin partizanë. Atëherë u binda se partizanët duhet të ishin shumë të fortë, gjersa u kishin futur tmerrin këtyre nemceve me sy të ligj prej ujku.

Të nesërmen Veliu iku në mal. Nëna qante dhe e puthte në ballë. Ai më përqafoi edhe mua. Ishte hera e parë që më përqafonte një burrë. Iu vara në qafë dhe s'kujtohesha ta lëshoja.

— Mjaft de, mjaft, lërimi këto! — thoshte babai me kokën mënjanë.

Veloja u ngjit e mori pushkën mbi trarët.

— Këtë lëre këtu, se më duhet mua, — tha babai dhe ia mori nga dora. — Do të të japin tjetër atje ku të vesh, veç a je i zoti ta shkrepësh!

U panë një çast në sy dhe u përqaftuan. S'i kisha parë kurrë të përqafoheshin ashtu. Pastaj Veloja u nis bashkë me një djalë tjetër nga fshati. Zarja i ndoqi gjer tutje. Kur u kthye, më tha se Veloja i pati thënë të mos mërzhitesha për mushkën. U skuqta nga turpi, kur u kujtova se këto fjalë i kishte dëgjuar babai. Kurse ai as që e kishte mendjen aty. Ishte kthyer brinjas dhe fërkonte sytë me cepin e xhokes.

Më vinte keq për babanë, por më shumë për vete. Isha ngjitur pas Velos si ajo kulpra që i qepet lisit dhe, kur mungonte ai, ndieja një boshllëk të madh. Ai sapo kishte filluar të më hapte shtegun e një bote të re dhe tani po ikte. Diçka ziente në thellësitë e mia gjatë kësaj përcjelljeje, pastaj ndjeva si m'u mblodh lëmshi i lotëve diku, aty mbi gjoks. Veloja ishte rritur shumë, kurse unë kisha mbetur një bimëz e vogël dhe e pafuqishme nën hijen e tij. M'u duk atë çast se edhe kjo kishte qenë një ëndërr, që do të shuhej me ikjen e tim vëllai, dhe unë do të isha përsëri ajo çupa kokulur e Humbëtirës që dija



vetëm të ruaja dhinë, të laja, të fshija, të gatuaja dhe të pritja në heshtje ditën kur do të më nisin në fatin tim. Por lufta kishte futur duart e padukshme te njerëzit dhe kishte trazuar thellë shpirtrat e tyre. Babai tërë jetën kishte menduar dhe qe përpjekur ta bënte Velon një blegtor të zotin, që të rriste mushka e dhi të mira e të mos prishte namin e derës e të Humbëtirës, kurse tani ia dha Luftës e sikur i harroi të gjitha. Erëra të reja po frynin. Fjalë të reja po hynin përditë në fjalorin tonë. Kuptimin mirë s'ua dinim, po i donim dhe s'i lëshonim nga goja.

Nga mesi i dhjetorit dëbora e ngricat shtrënguan keq. Dhe në një nga këto ditë të akullta te ne erdhi një burrë i dërguar nga vjehri im dhe i tha babait se Nurja i bënte të fala, ta bënte çupën gati për dy javë e jo për beharin tjetër, siç qe lënë fjala. Babai u kërrus, mendoj gjatë, në heshtje dhe i tha se ishte ngushtë e s'ia kishte vaktin. Pastaj, në atë kiamet dimri e lufte s'ishte kohë dasmash. Po lajmësi ngulte këmbë se Nurja ishte sëmure e s'besonte ta nxirrte dimrin, ndaj donte ta martonte edhe djalin e vogël, sa qe akoma gjallë. Për të tjerat, kishte thënë Nurja, krushku le të mos e vrasë shumë mendjen.

— «Miqësia shëndoshë e zemrat gëzuar», më tha Nurja. «Krushkut të m'i thuash të ma dërgojë çupën me ato që ka veshur, se s'e bëra mik për një barrë leckë, po për emrin e mirë e për çupën» — tha i dërguari i vjehrit.

Kisha ngjeshur veshin pas derës dhe dëgjoja. S'kisha përgjuar kurrë dhe isha rritur si të gjitha çupat e Humbëtirës me bindjen se të përgjuarit është një turp i pafalshëm. Por atje në dhomën e zjarrit po flitej për jetën time, dhe kjo më tërhiqte me një forcë të pamposhtshme.



I dërguari i vjehrrit tim kishte ardhur me një vendim të prerë dhe as që kishte ndër mend të tërhiqej nga kundërshtimet e babait. Tani i kishte thënë të gjitha ç'e patën porositur dhe priste fjalën e fundit. Por babai heshti gjatë dhe, me siguri, trazonte zjarrin me mashën e shtrembër, siç bënte gjithmonë kur zihej ngushtë. Zemra më rrihte gjoksin si një bishë e vogël e trembur dhe e egërsuar, që sulmon verbërisht për të dalë nga kafazi, ku e kanë mbyllur.

E pritja përgjigjen e babait me një ndjenjë të turbullt. Që mbas fejesës në shtëpinë time isha e përkohshme, si një mysafir që s'dihet kur ka ardhur, por që jeton me ditën e largimit, dhe të gjithë merren me përgatitjen për udhëtimin e tij. Kurse atje ku do të shkoja, unë jetoja me mungesën time. Për mua flitej çdo ditë si për një njeri që kishte qenë gjithmonë aty, por që kishte ikur s'dihej që kur diku dhe pritej të kthehej së shpejti. Në shtëpinë time po rritej dhimbja e ndarjes, kurse në shtëpinë e burrit gazi i pritjes. Unë sillesha midis tyre, pa ditur ku të qëndroja. Këtë do ta zgjidhnin disi fjalët e babait. Për ne gjithmonë dhe për gjithçka vendosnin të tjerët.

— Epo, goftë e bërë, or mik! — tha më në fund babai.

Fjalët e tij i mbështillte një psherëtimë e thellë. Bishëza që më rrihte gjoksin, sikur lëshoi një kuitje habie dhe humbi. Motra e vogël ishte ngritur ndenjnjur mbi shtrojet dhe kishte ngulur mbi mua shikimin e ngrirë të syve të saj të trishtuar e të trembur. U shtriva dhe i mora kokën në gjoks. Doja t'i thosha të qetësohej dhe të flinte, se ishte e vogël dhe s'i kuptonte këto gjëra, por s'munda. Sytë e saj, që s'më

ndaheshin dhe pritnin, s'kishin atë kuriozitetin femijnor për të mësuar sekretin e më të mëdhenjve. Me shqetësimin tim ajo jetonte të ardhmen e saj.

Të nesërmen jeta në shtëpinë tonë filloi të lëvizte ndryshe. Të gjithë nguteshin e bëheshin nervozë me shkak e pa shkak. S'mbahej mend të qe bërë ndonjë dasmë në fshatin tonë në kohë të tillë. Nënua vinte vërdallë me një merak të madh dhe më dukej sikur ato dy javë ajo s'vuri gjumë në sy. Po zbehej e po tretej. Dikush duhej të zbriste në qytet për të blerë disa gjëra. Por ato rrugë s'ishin për babanë. Veloja kishte ikur me partizanët e s'dinim si ta lajmëronim.

— Ka një dasmë ai atje, — tha babai dhe u nis vetë.

#### IV

Humbëtira jetonte me lajmet e luftës dhe me përgatitjet për dasmën time. Disa habiteshin me këtë ngutje dhe mendonin se kushedi ku do ta kishte hallin vjehëri im. Gratë e vajzat hynin e dilnin dhe kërkonin punë për të përgatitur pajën time. Nënua ngrysej e gdhiehej me lotë në sy, ndërsa unë sikur isha shushatur dhe s'më bënin duart për asgjë. Moshataret më shikonin me një sy ziliqar e mua më dukej se ato ishin akoma femijë dhe s'kuptonin asgjë nga kjo botë. Lajmi i papritur i dasmës sikur më kishte hedhur një lak në fyt, dhe ditët e shqetësuarat që mezi shtyeshin, sikur ma shtrëngonin atë pareshtur e më merrnin frymën. Ditët e fundit gratë filluan të më mbytnin me ato porositë e tyre, që i dëgjoja kokulur e me faqe të skuqura prej turpiti. Gjithçka më ngacmonte mendimin se do të shkoja



në një botë të panjohur, ku nuk e merrja dot me mend si do të orientohesha. Disa nuse qeshnin e thoshin se e kisha marrë me shumë frikë, se vajza, që kur vjen ndër mend, duhet të jetojë me martesën e vet, por kohët kishin ndryshuar, shpirtërat tona i kishte trazuar lufta. Ajo po hynte kudo, edhe në dasmën time, megjithëse atëherë unë nuk mund ta kuptoja këtë. Mendimet e mia kishin marrë udhët e kërkonin nëpër dimër atë Ftonjarin e panjohur. Ç'fshat ishte ky? Ç'njerëz ishin ata, me të cilët do të rroja një jetë të tërë? Si ishte ai?... Po ai çasti i tmerrshëm kur do të mbeteshim vetëm të dy! Çfarë do të më thoshte?! Çfarë do t'i thosha!? Do të më ngjethëj, do të më digjej apo do të më ngrinte trupi, kur të ndieja dorën e tij! Këtu filli i mendimit më këputej prej frikës e prej turpfit dhe më rridhnin lotët, ca lotë të papërmbajtshëm, që i ndieja vetëm kur më pikonin në mjekër. Gratë vazhdonin gjithnjë me ato këshillat e tyre, dhe unë dalngadalë sikur po humbja ndijimet.

Kështu më gjeti e shtuna, dita e fundit në shtëpinë time. Njerëzit lëviznin pa pushim, megjithëse shumica vërtiteshin kot, për t'i mbushur mendjen vetes se po merreshin me diçka. Xhaxhai dhe disa burra të tjerë i thanë babait të mos harxhohej, se kohët ishin të vështira e s'dihej si vente puna gjer të mbaronte lufta.

— Keq pa keq, pesë para dasmë do t'i bëj edhe për këtë. E kam evlat, s'e kam gjetur në rrugë.

Dhe dasma u bë dasmë. Njerëzit pinin, këndonin, uronin. Uronin për mua, po më shumë për Luftën e për Velon, të kthehej shëndoshë e t'i hanin dasmën. Konakët kutërbonin erë gjellësh, raki mareje dhe duhani të fortë. Këngët ishin të zvergëta. Këngë të vje-

tra hallesh, por u kënduan edhe këngët e reja të Luftës, që ishin ngjitur gjer në Humbëtirë. Gjithçka më trishtonte, më lodhte, më trulloste. Vajzat e gratë që më kishin vënë në mes, i dëgjoja si përgjumësh. Mbas mesnate më thanë të flija nja tri-katër orë, se isha për rrugë dhe atje ku do të shkoja, do të rrija pa gjumë edhe të nesërmen mbrëma. Nuk kundërshtova. Por sytë as që i mbylla dot. Mendja më fluturonte tutje, nga Ftonjari, tek ata njerëz të panjohur dhe sidomos tek ai... Mbulova kokën dhe pëshpërita emrin e tij: «Gani». Sikur nxora hekur të shkrirë nga goja. Një fytyrë e panjohur m'u shfaq papritur para syve të mi të turbullt. Një fytyrë pa formë, me ca sy të mëdhenj si të mushkës e me flokë të ngritur përperjetë. Pastaj një palë duar si bigaçe m'u lëshuan përsipër, dhe unë kafshova jorganin që të mos thërritja. Kalova çaste të gjata agonie. Pëshpërita edhe një herë emrin e tij. Por ai nuk m'u shfaq më. M'u duk sikur dëgjoja emrin tim. Zëri më vinte si me të qarë. Pastaj ndjeva se dikush vuri duart mbi shpatullat e mia. Kërceva e trembur, duke hedhur jorganin tutje. Ishte nëna.

— Ngrehu, bijë! — më përkëdheli ajo. — Babai është pirë e të kërkon. Ngrehu, xhan!

Dita sa kishte filluar të fekste. Trupi më dridhej dhe s'e ndieja timin. Nëna kishte qëndruar në mes të dhomës me duar të kryqëzuara mbi bark dhe më shihte me ata sytë e dhimbshëm, nën të cilët pagjumësia dhe shqetësimi kishin varur dy qeska ngjyrë gushëpëllumbi. U çapita ngadalë e më dukej se qafa s'ma mbante dot kokën e rëndë e të turbullt. Dhoma ishte mbushur me mjegullën e tymit të duhanit dhe kishte një erë që të merrte frymën. Babai as që m'i shtiu sytë. Mbështetur pas murit, atje te vatra, ku



rrinte gjithmonë, ai dukej sikur flinte me sy hapur. cigaren kishte harruar ta hiqte kushedi qëkur e ajo kishte zenë një kapuç të madh hiri sa gishti i dorës së tij. Qëndroja më këmbë përballë tij dhe pritja. Me siguri, mendova, porosinë e fundit, të rrepta, të prera dhe të papërsëritshme.

— Rri! — më tha ai ngadalë, pa lëvizur.

M'u duk i lodhur, i vrarë, i mërzitur. U ula pranë tij. Ai u ngrit më gjunjë dhe zuri të trazonte zjarrin me mashë.

— Më ke baba e të kam çupë. . . — filloi të fliste, pa e ngritur kokën. — Po kështu e ka kjo dynja... Erdhi dita të ikësh në fatin tënd, si tërë çupat. Më thotë mendja se do të shkosh në shtëpi të mirë. Pardje Velua më kish çuar fjalë me Demirin, se nja dy javë të shkuara paska qenë me ca partizanë në shtëpinë e Nures. I kishin pritur mirë shumë. Velos i vjen keq që nuk erdhi dot në dasmë. Veçse më dërgonte amanet që mos të ta thyej zemrën për asgjë. Ti e di sa të do yt vëlla. Ne s'i kemi dashur motrat kaq. Po mirë më vjen, se evlatë ju kam.

Heshti dhe dridhte cigare, ndërsa ajo e ndezura po digjej pa u pirë atje, mbi plloçën e vatrës. Ishte turbulluar keq. Një bisedë të tillë as që e pritja. Më dukej sikur më përkëdhelte. Dhe ne s'ishim mësuar të na përkëdhelnin! E kuptoja se kishte akoma për të thënë, por përtypej e përtypej dhe s'e nxirte dot fjalën. Tek e shihja fytyrën e tij të rreshkur duke pritur, më hynë të ngjethura, ndonëse fytyra më përcëllonte nga drutë e thata, që digjeshin me flakë të mëdha, duke kërcitur.

— Ndoshta të kam sharë, ndoshta të kam rënduar, të kam munduar ndonjëherë. . . — zuri të fliste prapë babai. — M'i bëj hallall! Të kam dashur, po

aq kam ditur. Si tërë bota dhe unë! Ku do bëhesha më i mençëm nga të tjerët... Yt vëlla më dërgoi fjalë, siç të thashë dhe, kur të tërë pinin e këndonin, unë vritja mendjen. Më dërgonte amanet që mos të ta thyej zemrën për asgjë. Amaneti i luftëtarit është më i rëndë se guri i varrit. Ndaj të thirra. S'më zinte as rakia e as gjumi. Paç mend e gëzofsh jetën atje ku të vesh, çupë e babait! Tjetër s'të them asgjë. Yt vëlla do të vijë andej nga Ftonjari, do të të shohë e do të të llafosë. Bëj si të të thotë ai. Të do shumë e ndofta di ca më tepër nga unë.

Vazhdoja të dëgjoja gjithnjë kokulur. Veç kur ndjeva duart e tij të ashpra, që më kapën në të dyja faqet si me frikë, se mos më lëndonin plagët, dhe më tërhoqën. Babai më puthi në ballë. Turfulloja e tëra përbrenda dhe ndieja se një lëmsh lotësh më kishte mbërthyer për gryke e më merrte frymën. Kjo ishte diçka e befte dhe tronditëse, e papritur dhe e papërsëritshme në jetën time. Do t'i ndieja duart e tij të ashpra mbi faqe tërë jetën, s'do ta harroja kurrrë zërin e tij atë mëngjes. Dhjetëra duar më shtynin t'i varesha në qafë dhe ta derdhja mbi gjoksin e tij tërë atë lumë lotësh që më gurgullonte përbrenda.

Në hajat u dëgjuan zëra grash.

— Shko tani! — tha babai, duke u mbushur thellë me frymë dhe, si mblodhi këmbët kryq, u mbështet prapë pas murit të rrjepur nga xhokja e tij e ashpër.

Me orë të tëra nuk e mblidhja dot mendjen. Nuk arrija të kuptoja ç'po ndodhte me babanë.

— Ndoshta lufta... — thashë dikur e pasigurt me vete.

Të nesërmen do të kuptoja se lufta ishte çelësi i



gjithë të papriturave e të pakuptueshmeve, që po ndodhnin në shtëpinë time, në Humbëtirën tonë, në dasmën time...

## V

Krushqit erdhën shpejt dhe iu lutën babait që të mos i vononte. Rruga ishte e gjatë, dëborë gjer në brez e prapë pritej të binte, lufta nëpër këmbë! Fytyrat u qenë bërë gjak të kuqe nga të ftohtët dhe, sa qëndruan aty, avullonin nga goja.

Unë i pashë krushqit vetëm kur më nxorën për të ikur. Nëna qante. Sytë i kishin humbur nëpër zgavrë e thella e buza e mavijosur i dridhej. Zarja më kishte mbërthyer duart e s'mi lëshonte. Edhe gratë e vajzat e tjera qanin. Më shumë për zakon, sesa prej dhimbjes së ndarjes. Mua më kishin ngrirë lotët, dhe rrëkeja e tyre m'u derdh vetëm kur më hipën në kalë. Më dhimbsej sidomos babai. Ndieja akoma buzët e tij mbi ballë dhe para kësaj puthjeje s'më hynte në sy asgjë. Dhe, sikur të mos i vinte zor nga të tjerët, ai do të më puthte përsëri. Këtë e shihja qartë në sytë e tij të ndezur nga një mall i papërshkrueshëm, por i përmbajtur.

— Velos Ftonjarin ia zë këmba më shumë se këtë Humbëtirën tonë. Bëji të fala shumë dhe thuaji të mos ketë merak për asgjë.

Këto ishin fjalët e tij të fundit. Doja t'i hidhja duart në qafë, por ai m'i shtrëngoi në pëllëmbët e tij të ashpra dhe m'i largoi. Duart e tij dridheshin, dhe mua më mbyti ngashërimi. Pastaj u nisëm. Ishim katër: Xhezoja, dajoja i burrit tim, një mesoburrë fytyrëhequr e, me sa dukej, shpirtbutë; Tahiri, ku-

nati, im, trupmadh, me mollëza të kërcyera e me një palë sy të mëdhenj e të vëmendshëm, që të qetësonin kur i shihje; tjetri quhej Luto, burrë i bëshëm edhe ky, po me një fytyrë që e tregonte ca më të sertë se të tjerët. Dhe unë, çupa e Humbëtirës, që shkoja nuse në Ftonjar nëpër këthizë të dimrit e të luftës. Dëborë kishte rënë shumë, një dëborë e ngrirë, e ashpër, që kërciste nën thundrat e kafshëve. Dhe pat nisur të qëmtonte përsëri një dëborë e imtë dhe e ashpër si oriz. Nëpër gryka frynte erë dhe ajo na përcëllonte fytyrat me saçmat e bardha.

Një gjysmë orë, në mos më shumë, burrat s'këmbyen një fjalë, veç rrallë e tek u flitnin kuajve, kur u fundosnin këmbët në dëborë apo kur pengoheshin, të pamësuar në udhë të tilla si të Humbëtirës. Karvanit i printe Tahiri. Pas tij vinte Xhezoja, i cili kur e kur më hidhte nga një vështrim të ngrohtë e dashmirës, dhe unë ulja kokën e turpëruar. Pas meje vinte Lutoja, njeri i heshtur e si i përgjumur. Pas samarit të kalit të tij që lidhur Murra, mushka plakë e shtëpisë sonë. Babai e kishte hequr mënjanë Xhezon, si krushk i parë që ishte, dhe i kishte kërkuar ndjesë që nuk do t'i jepte mushkën e re që kishte rritur për të bijën. Xhezoja i tha se i dinte të gjitha.

— Do t'ju jap Murrën, — i tha babai. — Është ca e vjetër dhe e punuar shumë, po hajvan i fortë dhe i urtë si njeri... Ç't'i bëjmë, na zuri tani...

Xhezoja kundërshtonte dhe ngulte këmbë se kishte porosi nga vjehri im që punën e mushkës të mos e zinte në gojë, por dhe babai s'kishte ndër mend të lëshonte pe. U grindën kështu një copë herë, gjersa Murra hyri në karvanin tonë, ngarkuar me një këndes plaçka, që shpija unë në shtëpi të burrit.



Si u nisëm, Xhezoja i tha babait se mushkën do t'ia kthenin prapë. Ai nuk u përgjigj.

Duke u përkundur mbi samar, ashtu si pa kuptuar, ktheja kokën dhe shikoja mushkën e murme, të vetmen gjë që më lidhte me shtëpinë time, me njerëzit e mi, me vajzërinë time, me fshatin tim, që kishte humbur tashmë në bardhësinë e pafund të maleve. Dhe më dukej sikur edhe sytë e Murrës më shihnin me një dhemshuri të çuditshme si të babait. Pse s'më hipën në mushkën time, po më hodhën mbi samarin e këtij kali të panjohur!? Më kishte pushtuar një marrjemendsh e një trubullirë e përgjithshme, sikur një dorë e fuqishme dhe e panjohur më kishte rrëmbyer nga fshati im dhe më kishte hedhur në ajër, ku era dhe dëbora talleshin me mua dhe s'më linin të bija në tokë. Kurse mushka plakë ecte e sigurt dhe si me përtesë, sikur s'e kishte mendjen te rruga, po kushedi se ku. Dhe atë çast e pata zili. Ajo kishte vite e vite që udhëtonte dhe kishte parë shumë e shumë gjëra larg Humbëtirës. Kishte qenë në qytet, kishte qenë në mulli, kishte qenë krushkë nëpër dhjetëra dasma, kishte qenë me Velon në mal, te partizanët. Kishte parë shumë Murra. Kurse unë s'kisha qenë askund. Kur isha e vogël, më dërgonin te dajoja në Tërbonjë, por që atëherë kishin kaluar dhjetë vjet. Veç kësaj Tërbonja s'ishte ndonjë mall më i mirë se Humbëtira jonë.

Më zgjoi nga këto përçartje të dhimbshme Xhezoja, që i thirri Tahirit të qëndronte. Duke u shpërgjumur, më mbetën sytë te shtëllungat e avullit që lëshonin kuajt dhe njerëzit. E kisha harruar fare të ftohtët dhe papritur e ndjeva atë gjer në palcë. Fytyra, duart, këmbët më kishin ngrirë, kurse majën e hundës sikur ma pickonin pareshtur një tufë gre-

rëzash. Krushqit kishin qëndruar mbi kuaj dhe pritnin ç'do të thoshte Xhezoja. Ai kërcëu nga samari, shkundi nja dy herë këmbët, hukati duart, i ngrohu një çast nën sjetulla dhe m'u afrua mua.

— Ftohtë shumë, nuse. Qamet. Na griu. Atje në mal e, çka, po këtu na griu fare... Po ti qenke bërë mavi, moj e uruar.

Tahiri me Luton po më shikonin. Zbritën dhe ata nga kuajt e po më afroreshin si me turp.

— Të morëm sagllam në derë të babait e sagllam duhet të të shpiem në derë të burrit, — qeshi paksa Xhezoja. — Hop!

Dhe e pashë veten në ajër, në duart e këtij burri të panjohur, që më shtrëngonin për mes, si darë. Kur më lëshoi, këmbët s'i ndieja fare dhe mezi u mbajta. Ai e hapi njësh velenxën e palosur mbi samar dhe më ngriti përsëri me ato duart e hekurta, sikur të isha një fëmijë. Më mbështolli mirë e mirë me velenxë, duke më lënë vetëm kokën jashtë. M'u duk sikur më kishin futur në një thes, por të ftohtët sikur s'po e ndieja më.

— Nxirre atë të shkretë, ta ngremë nga një herë, mos na nxehet ndonjë çikë gjaku. — tha Lutoja.

Xhezoja nxori nga hejbetë një shishe të madhe me raki, që ua kishte dhënë babai ta kishin për rru-gës, dhe ata hoqën nga ca gurmaze të mira.

— Do ta ngresh edhe ti një herë? — tha Tahiri dhe më zgjati shishen.

Unë ula kokën dhe u skuqa.

— Kemi dhe nja dy sahat të mirë, — tha Xhezoja, kur kalorësit u gjendën përsëri mbi samarët e kafshëve. — Mos u mërzit, nuse! Hë xhan! Po pate ftohtë, a po deshe gjë, se njerëz të gjallë jemi, na thuaj, mos ki turp.



Dhe morëm rrugën përsëri. Era sa vinte e bëhej më e hidhur, dhe ata më të rrallë këmbenin ndonjë fjalë me zë të lartë. Mundohesha të mos e ktheja kokën pas për të parë Murrën. Nuk doja të mendoja më për ç'lashë pas, por për Ftonjarin, që më priste me njëqind të panjohura e që më dukej sikur pas çdo kthese do të më shfaqej befas. Ndosh-ta në këtë udhë m'i futën mendimet këta burra të urtë e të heshtur, që më kishin vënë në mes. Dimrin e harrova përsëri. E kisha harruar edhe luftën ato çaste, por ajo nuk më kishte harruar... Diku do të më dilte përpara ashtu si s'e kisha parë kurrrë, do të hipte mbi mushkën time, do të vinte me krushqit në dasmën time, do të hynte në thellësitë e mia dhe do të më mësonte atë që s'ma kishin mësuar as tetëmbëdhjetë vjetët e mi, as prindët, as gratë, e nusët e fshatit. Dhe për këtë unë shpesh e ngatërroj ditën e dasmës me ditën e lindjes sime...

## VI

Ai dukej pothuaj krejt pa jetë. E gjetëm rrëzë koritës së një mulliri të braktisur. Në fillim Xhezoja pa gjurmët e tij, ca gjurmë të çuditshme, që e prisnin rrugën tërthori. Diku dukeshin si ca gropa të mëdha në formë të çrregullta, diku shkriheshin e formonin mbi dëborë një kanal dredhak, që skuqte aty-këtu nga gjaku. Xhezoja mbajti kalin dhe ndoqi gjurmët me sy. Ne ndiqnim sytë e tij, që kalonin përtej rrugës nëpër një vrugë të ngushtë, që dukej sikur e kishte lënë një kafshë e plagosur, që ishte zvaritur në grahmat e fundit. Dhe pamë atë, mbështetur pas koritës së vjetër, që na kishte ngulur sytë

me pushkë në duar. Xhezoja u hodh nga kali dhe ndoqi vragën e kuqe. Në pritnim majë kuajve. Kur Xhezoja iu afrua, njeriu që dukej si i ngrirë, ngriti armën dhe thirri:

— Mos u afro!

— Prit, o njeri, mos u rrëmbe! Për ndihmë po të vij. Kush je ti? — tha i qetë Xhezoja dhe qëndroi.

— Po ju ç'jeni?

— Dasmorë, — tha Xhezoja. — Pamë gjurmët me gjak e qëndruam. Ti duhet të kesh plagë. Partizan më dukesh. . .

Ai uli pushkën dhe Xhezoja u afrua. U përkul mbi të, këmbyen ca fjalë, po ne s'dëgjuam gjë. Pastaj Xhezoja thirri Tahirin dhe Luton. Tahiri zbriti dhe e hoqi karvanin nga korita. S'kisha parë njeri të tillë. I panjohuri hyri i gjithi në sytë e mi të etur dhe ndjeva se diku zuri vend në brendësitë e mia. Në fytyrën e tij të nxirë e si të ngurosur nga lodhja, nga dhembja e plagëve dhe nga të ftohtët sytë e bukur derdhnin dritën e magjishme të njeriut të fortë e të mirë. Ai na pa një çast me radhë, pastaj mbështeti pushkën pas supit dhe me duart e mavijosura, që s'i bindeshin, mundohej të lidhte plagën e këmbës me një copë leckë të këputur kushedi nga ç'plagë e trupit. Më dukej sikur papritur ai do të mbaronte aty në sytë e mi dhe më zinte ngërçi prej dhembjes.

— Rakinë! — thirri Xhezoja.

Tahiri nxori shpejt e shpejt shishen dhe i hoqi me dhëmbë koçanin e misrit, që kishin vënë në vend të tapës.

— Jepi, hiq nja dy herë, — i tha Xhezoja partizanit dhe, si i hodhi krahun supeve, i vuri grykën e shishes në buzë.



Partizani mbylli sytë dhe e mbyti kolla. Por Xhezoja i tha të hiqte edhe një herë.

— Si e ke punën? — e pyeti, kur ai e mori disi veten.

— Keq! — tha mbytur partizani. — Kam një punë me zarar e që s'më pret, po rashë në përpjekje dhe u plagosa ligisht. Le të isha plagosur në një vend tjetër, po jo në këmbë... Ata më ndoqën, por u humba... Akoma më ndjekin, me siguri... Nuk ecja dot më dhe u zvarita këtu të lidhja njëfarësoj këtë djallo plagë e të nisem prapë... Po më kanë ngrirë edhe duart... Po mundët, ma lidhni një çikë. Puna s'më pret. Jam korrier. Me shpirt a pa shpirt, gjer në mes të natës duhet të sosem në vend.

— Ku? — pyeti Xhezoja.

— Korrieri e lë amanetin në minutën e fundit, — tha partizani.

— Ke hak. S'duhet të të pyetja, — tha Xhezoja dhe filloi të rrëmonte nëpër xhepa për ndonjë shami a për ndonjë plaçkë tjetër. Këtë punë bënin dhe të tjerët. Mua më kishin mbetur sytë te plaga e tij. Rreth saj, atje mbi kupën e gjurit dhe gjer poshtë mbi opingë varej një rrëkezë gjak i zi, i mpiksuar, si mëlçi. Duhet të kishte humbur shumë gjak. Krushqit e mi i bashkuan të tria shamitë e filluan të mbështillnin plagën e larë me raki, por, pa e lidhur mirë akoma, gjaku zuri të ridhte sipër shamive. Partizani më shikonte me ata sytë e këputur por çuditërisht njerëzorë dhe sikur më kërkonte të falur. U drodha dhe kërcëva prej kalit.

— T'i vëmë një plaçkë më të trashë, — foli për herë të parë gjatë gjithë asaj udhe dhe fillova të gërmoja në barrën e mushkës, që mbante pajëzën time. Nxora të parën plaçkë që më zuri dora. Ishte një kë-

mishë humai e qëndisur rreth grykës. U mundova ta çaja më dysh, po plaçka qe e fortë. Partizani dhe krushqit më shihnin si me habi. Ula kokën dhe u mundova përsëri, por kot. Tahiri ma rrëmbeu dhe e shqeu me ato duart e mëdha e të rreshkura.

— Rakinë! — thirri Xhezoja dhe zuri t'i lante plagën përsëri, po gjaku s'pushonte.

— S'ka kohë për këto gjëra, — thoshte partizani. — Vetëm lidhmani, shtrëngomani fort sa të më shpjerë gjer në vend.

Krushqit shikonin gjakun dhe heshtnin.

— Që të pushojë gjaku... — tha Xhezoja.

— Do ilaçin e trupit, — e pasoi Lutoja dhe, tek më shihte me bisht të syrit, si me turp, po matej të thoshte diçka. Unë diç mora me mend dhe u ktheva shpinën.

Sytë e tij ishin hapur shumë dhe prej tyre rridhte një vështrim qortues për atë që thanë krushqit e mi.

— Lërinia ato, vetëm lidhmani, shtrëngomani fort, sa të më shpjerë gjer në vend, pastaj shohim e bëjmë, — tha partizani.

I mora Tahirit nga duart këmishën time të grisur dhe u përkula mbi këmbën e plagosur të partizanit.

— Prit! — tha Lutoja dhe e pllakosi plagën me duhan.

Dhe unë ia lidha si munda. Partizani bëri të ngrihej, po s'e mbanin këmbët. Kjo e dëshpëroi shumë, shtrëngoi nofullat dhe sytë e tij u hapën çuditërisht, sikur do të dilnin nga zgavrat e zeza e do të binin mbi dëborë.

— Afroni mushkën! — urdhëroi Xhezoja dhe po hiqte çizmet e tij.



Partizani kundërshtonte, po Xhezoja bënte sikur nuk e dëgjonte. I hoqi opingat dhe i mbathi me zor çizmet e tij të zeza.

— Kot lodhesh, — tha partizani, — me këto nuk eci dot më keq.

— Ç'të ecur, o derëzi... Ti je bërë meit... Ke humbur gjysmën e gjakut. Do të vish me ne.

— Jo! — kundërshtoi partizani. — Gjallë a vdekur duhet të arrij atje ku jam nisur të vete.

— Mirë, o djalë, mirë... Të marr vesh... Edhe atje do të shkosh, mos ki merak, po kështu si je bërë ti, do të vdesësh rrugës. Hajde me ne, pa do ta rregullojmë edhe atë punë. — Xhezoja i fliste butë, sikur e përkëdhelte. E rrëmbeu në duar dhe e vuri mbi samar të mushkës.

Partizani kundërshtonte gjithnjë e lutej që ta zbritnin.

— O shok, po dëgjo, puna s'më pret... Jam korrier unë, byrazer... Lajmi ka rëndësi të jashtëzakonshme. Ti nuk i di këto punët e luftës.

— I dimë edhe ne, i dimë, mos u mërzit. Çoç luftojmë edhe ne. Gjer në mes të natës do të të shpiem atje ku ke punë. A mbahesh dot?

Partizani s'foli. Tahiri hoqi bërrucin e tij dhe e mbështolli mirë e mirë, që të mos e hante era. Xhezoja, si i lau me dëborë opingat e përgjakura, i mbathi dhe kërceu mbi kalë.

— Shoko! O shoko! — i thirri partizani Xhezos. — Lemëni, më mirë. Kjo është punë me rrezik. Në fshat ju presin të shpini nusen.. Po na dolën përpara ata që më ndjekin...

— Atë llaf mos e thuaj më! — ia preu fjalën Xhezoja. — Po na doli njeri përpara e të na pyesë, do të thuash se martojmë Ganinë në Ftonjar. Nusen

e kemi marrë në Humbëtirë. Ti je dajua i madh nga Veçishti. I mban mend?

Xhezoja ia përsëriti edhe nja dy herë këto fjalë, pastaj i dha shishen e rakisë e i tha ta hiqte nganjëherë rrugës.

— Po pushkën? — pyeti Lutoja.

— E kam fshehur nën velenxë, — tha Tahiri.  
Dhe u nisëm me një krushk më shumë.

## VII

Premë për shkurt nëpër një rrugë që nuk vozitej shumë. Dëbora kishte mbuluar gjithçka, po rruga duhet të qe shumë e keqe, se kafshët pengoheshin nën qilimin e bardhë.

Unë e kisha harruar dasmën time. Kisha harruar nënën që e lashë me sy të buhavitur, shikimin e çuditshëm të babait dhe puthjen që i mbeti pa më dhënë, konakët e errët e të trishtuar, ku kisha lindur dhe isha rritur, njerëzit e dashur, ahurin, dhitë... Kisha harruar krushqit dhe Ftonjarin me enigmën e tij, po harroja edhe atë, të cilit kisha turp t'i kujtoja emrin edhe me mend. Më kishin ngrirë sytë te partizani që kolovitej mbi mushkën time si përgjumësh. Ai kishte hyrë befas në jetën time si diçka e jashtëzakonshme, që më hutonte dhe më magjepste.

Herë-herë më bëhej sikur në vend të tij ishte im vëlla, po prapë s'më mbushej mendja që ai të qe bërë akoma partizan i tillë, që të ishte kaq i fortë dhe kaq i mirë. Partizanin e panjohur në sytë e mi e mbështillte një mirësi e përgjithshme, ngacmuese, tronditëse.



Më shpërgjumi zëri i Xhezos. Para nesh kishte qëndruar një fshatar me fytyrë thatanike, të nxirë e të tharë edhe më nga të ftohtët e që nuk dallohej në qe pesëdhjetë apo shtatëdhjetë vjeç. Ishte kërrusur mbi samar të kalit, nën një gunë të hirtë dhe veshët i kishte mbështjellë me një peshqir. Unë s'e pata vënë re, kur na qe afruar, dhe m'u duk sikur doli befasi që poshtë dëborës së trashë.

— Paskeni bërë rrugë të largët, o miq, — tha plaku. — Ç'ju paska nxjerrë në këtë qamet? Le që mos e zëntë njeriun, thuaj, ja, si puna ime...

— Jemi dasmorë, — tha Xhezoja. — Morëm nuse në Humbëtirë.

— Me trashëgim! — uroi plaku.

— Gaz paç! — ia ktheu Xhezoja. — Si është rruga këtej?

— E kanë zënë, — tha plaku. — Kishin dalë tre nemce të gjatë si hostenë te Guri i Dikes. Ishin çakërdisur fare. Xhan, o ujk, të thuash. Më kontrolluan mbarë e prapë, kusur s'më lanë... Lëkurën sa s'më hoqën! Për besë, keq e keni. Në më dëgjofshi mua, bjerini me të prerë këtej nga zalli e dilni mbi Vastar.

— A çahet dëbora se?! — tha Lutoja me dyshim.

— Epo... Kur të zë me të ligun... Dalçi shëndoshë e me trashëgim! — uroi dhe një herë plaku dhe i foli kalit

Xhezoja mbajti një hop sytë andej nga na këshillor plaku të shkonim, pastaj i doli mushkës më krah, nxori shishen nga hejbetë dhe ia dha partizanit:

— Ngreje, djalë, hiq dhe nja dy gurmaze. Sikur të nxeh gjakun kjo e shkretë. Sa për atë punë, mos u mërzhit, do çajmë, se s'bën. Kjo rrugë mezi

bëhet në behar e jo tani në palcë të dimrit, po do t'i hamë t'ëmën, dëgjo Xhezon ti...

Partizani iu bind pa folur. Kthyem kafshët dhe morëm rrëzë kodrës në të djathtë.

— Dhe mos harro ç'të thashë. Martojmë Ganinë në Ftonjar. T'anë e Ganos e quajnë Nure, — vazhdonte Xhezoja. — Ti je dajua i vogël. Unë jam i madhi. Më quajnë Xhezmi. Nusen e kemi marrë në Humbëtirë. Ky është vëllai i dhëndrit, e quajnë Tahir, këtë tjetrin e quajnë Luto...

Partizani dëgjonte dhe tundte kokën ngadalë, pa nxjerrë zë.

— Po ty si të quajnë? — e pyeti Xhezoja, si hoqi një gurmaz të mirë nga shishja.

— Besho, — tha partizani.

— Emrin e nënës e ke këtë, apo të luftës?

— Të luftës.

— Ta gëzosh! E, siç të thashë, ne jemi vëllezër të dy dhe babanë na e quajnë Syrja.

Partizani belbëzonte me vete ato që i thoshte Xhezoja.

— Mbai mend këto, se s'dihet si vete puna dhe mos ngatërrohemi. Dëgjon, byrazer?

— Dëgjoj, shok, dëgjoj, por, po nuk arrita gjer në mes të natës atje për ku jam nisur, janë kot të gjitha. Lajmi ka rëndësi të jashtëzakonshme. Shpjerme në gjer te Pellgu i Kulmaqeve dhe lemëni aty, pa do bëj si do bëj e do sosem.

— Ato që të thashë unë, shiko mos harrosh ti, pa për atë që thua, flije mendjen e mos ki merak. Të arrijmë shëndoshë e mirë në fshat pa ... Këtu e ke shishen. Ngreje nganjëherë...

Dhe vazhduam rrugën nëpër dëborë e nëpër mendime. Dëborë u vinte kafshëve deri mbi gju dhe



ato mezi çapiteshin duke u penguar në rrugën e parrahur. Mua s'më ndaheshin sytë nga partizani, që lëkundej mbi samar të mushkës dhe kisha humbur e gjitha në këto të papritura, që po ndodhnin ditën e dasmës sime. Krushqit më kishin harruar. Por ai, i panjohuri, i paharruari, që lufta e kishte bërë aq të mirë e të fortë e që i kishte vënë emrin e ri, Besho, hera-herës kthente me mundim kokën dhe më lëshonte një shikim të dashur e të dhimbshëm, që binte mbi mua si një rrëkezë e ngrohtë. Sytë e tij sikur më kërkonin ndjesë. Sy të tillë burrash, kaq të butë, s'pata parë kurrë.

— Ndal!

Ishte një zë i mbytur e i dridhur, sikur vinte nga nëntoka. Xhezoja mbajti kalin dhe të gjithë kthyen kokën rreth e qark, por s'dukej njeri. Unë ngriva e gjitha dhe mendja më shkoi menjëherë tek ajo dita kur erdhën gjermanët në fshat.

— Pushkën! — tha partizani dhe kërceu nga mushka, por u rrëzua dhe s'po ngrihej dot. Xhezoja e rrëmbeu në duar dhe e vuri prapë mbi samar.

— Prit njëherë, të shohim, — tha Xhezoja dhe iu drejtua atij që pat thirrur e që s'po nxirrte kokën — Kush je, more? Hej!

Partizani rrëmoi nëpër rroba dhe nxori një letër të palosur. Ishte tepër i shqetësuar. Atë çast ai i kishte harruar të gjitha dhembjet dhe lodhjet e rrugës.

— Xhezo, po ndodhi gjë, letra është nën kaptell të samarit, — tha partizani.

— Hicgjë s'do ndodhë, — tha Xhezoja. — Prit njëherë, se, më duket, janë nga ata minjtë e vrimave, që s'po dalin akoma.

— Ptu! Ku na u bënë sebeb, mor, që u lërofsha pragun, — shau Tahiri, i nxehur.

— Epo, luftë, or, de! — u nxeh edhe Xhezoja.  
— Rrini urtë e bëni si t'ju thonë. Unë jam komandant këtu! Dhe i kërceu kalit sikur të qe njëzet vjeç djalë dhe jo dy herë gjysh, nga i biri e nga e bija.

— Ti, Besho, bëhu i dehur, — i tha partizanit.  
— Të tjerat lëmi mua. Do bëjmë një çare.

Nga një guvë dolën dy njerëz të mardhur dhe na prenë rrugën, duke mbajtur pushkët drejt nesh, me gisht në këmbëz. Qëndruan nja tridhjetë metra larg, të gërmuqur nga të ftohtët dhe, me sa dukej, kishin frikë të afroreshin. I kisha ngulur sytë partizanit dhe më dridhej zemra, megjithëse, kur dëgjoja Xhezon, thellë më dukej sikur s'do të ndodhte asgjë.

— Ptu! Larot e djallit! — shau Lutoja, këtë herë nëpër dhëmbë.

— Mjaft, de! — mërmëriti Xhezoja. — Oj!

— Zbrituni hajvanëve, — tha njëri nga ballistët, me një zë të deformuar, sikur t'i ishte zënë nofulla.

— Mirë, o mirë, po e ke gabim, — tha Xhezoja dhe i nguli thembrat kalit. — Ne jemi dasmorë, siç e shikon.

— Ndal! — thirri ballisti tjetër.

Xhezoja bënte sikur s'dëgjonte dhe afrohej gjithnjë.

— Dasmorë, bre, siç e shikoni... Se mos është edhe kohë dasmash, po kështu na e solli siraja... Plaku është keq e i shkrepri: «O më sillni nusen ta shoh djalin të martuar, o s'më del xhani».

Karvani qëndroi përsëri. Kali i Xhezos tundte kokën dhe shkrofëtinte para ballistëve, sikur do t'i pështynte.

Xhezoja zbriti nga kali dhe hapi muhabet, pa i bërë syri tërr nga shikimet e tyre kërcënuese.

— Ama, dhe ju, or trima, keq po hiqni në këtë



pisk dimri... Edhe ne jemi tharë e bërë kërcunj... Kemi nja gjashtë sahat që udhëtojmë... Duam edhe nja tre sahat të shëndoshë gjer të sosim. S'mbahet mend ky qamet i sivjetmë!

Ai futi dorën në xhep, por njëri nga ballistët, kokëmadh, me sy të vëngër e si të shpëlarë, i vuri grykën e pushkës në gjoks.

— Duart lart! — dhe iu kthye tjetrit. — Kontrolloje, Malo!

Maloja kishte një fytyrë të vrarë lije, dhe mustaqet ngjyrë gruri i kishin rënë mbi gojë. E kontrolloi Xhezon, duke i shkuar duart mbi trup para e mbrapa dhe sytë e tij ngrinë, kur duart i prekën diçka të fortë në xhepin e Xhezos.

— Kutia e duhanit është, or i uruar, — tha Xhezoja. — Kot që na bini më qafë.

Mustaqelliu nxori kutinë e duhanit, e hapi dhe pastaj e futi diku nën gunën e tij.

Unë ia kisha ngulur sytë Beshos. Ai ishte bërë tamam i dehur, sikur të kishte pirë dy okë raki.

— S'ka si dasmat, bre, jo... S'ka, për kokë të kalamajve. Epo, një herë martohet njeriu i shkretë, de! Tym t'i dalë! — dhe ngriti shishen, sikur s'e vinte re vëngëroshin, që s'ia ndante sytë. — Merre! Ngreje dhe na uro njëherë, a derëzi, se je tharë e bërë kocunar. Unë, që thua ti, zoti kapedan, jam dajua i dhëndrit. Na, jepi një gurmaz.

Vëngëroshi zuri të lëpihej.

— Raki për sevda! Rrush safi, e pikës së parë, balli i kazanit! Hajd, të na trashëgohen! — dhe e ngriti shishen përsëri, po ballisti ia hoqi nga goja e ia dha ta provonte mustaqelliu. Metja piu si i babëzitur, përpoqi nja dy herë gjuhën dhe tundi kokën i kënaqur. Ia dha shishen tjetrit, por ai s'e ngriti. Kishte

ngulur sytë diku, mbi barrën e hajvanëve. Beshoja këndonte sikur të mos ndodhte asgjë.

*Në majë të malit ma kishe shtëpinë,  
Moj vetullkaleshe, gushatrendelinë.  
Me dorën e bardhë ç'ma fshije martinën,  
Moj vetullkaleshe, gushatrendelinë...*

Xhezoja ndiqte sytë e vëngëroshit dhe në skajet e ballit i kërcyen damarët si dy rrënjë hardhie që i kanë zbuluar gërryerjet. Ballisti e lëshoi shishen mbi dëborë dhe me armën ngrehur iu afrua kalit të Tahirit. Këtij i kishin kërcyer më keq se Xhezos. Edhe Beshoja s'këndonte më. U panë të gjithë një herë në heshtje, të vrenjtur e me nofulla të mbledhura dhe mua më thoshte zemra se do të ndodhte diçka.

Ballisti me sy të vëngër futi dorën nën velenxë dhe kapi pushkën.

— A kopukër, jo! — thirri ai dhe u mundua të tërhiqte armën. Por s'pati kohë se Tahiri, ashtu kaluar siç qe, i ra me shqelm në nofull dhe iu hodh përsipër. Xhezoja i kërcëu tjetrit, që s'i qe ndarë çap. U hodh edhe Lutoja e u bënë lëmsh nëpër dëborë. Si i vunë për fund, i hoqën litarin njërit kalë, i lidhën si deng kurriz më dhe u zunë gojët. Pastaj i hoqën osh dhe i plasën në atë guvën prej nga kishin dalë...

— Shumë ua zgjatëm, — thoshte Lutoja, kur u kthyen. T'ua kishim bërë avazë që në fillim. U vonuam kot me ca lapangjozët e m...

— Kishim armë e krisma mund të ndillte të tjerë, — tha Xhezoja — Bajgat e djallit! Janë fshehur këtu për t'i shpëtuar belasë e, kur iu mbush mendja se s'jemi nga ata të malit, na dolën me hyner! Sojsëzët e halesë! Ptu!



Dhe karvani ynë u nis përsëri. Burrat u qetësuan përsëri, veç kur e kur u këputnin nga një të sharë atyre që na kishin zënë rrugën. Mbas pak, për atë që ndodhi, flitnin si për një shaka të zakonshme.

Unë kisha rënë e gjitha në çuditë e asaj dite dhe s'u jepja dot rrugë mendimeve. Veç e ndieja, se ata që udhëtonin me mua, ishin bërë të dashur e të afërt sikur jetonin brenda meje. Zërat e tyre s'i dëgjoja me veshë, por diku nga thellësitë e mia, si zëra ëndrrash.

— Ama edhe ti, — i tha Xhezoja partizanit, — usta i mbaruar qenke, djall i madh... Sa bukur e vërtitje!

Po partizani s'fliste. Ai lëkundej gjithnjë e më shumë mbi samar e më dukej sikur nga çasti në çast do të binte. Xhezoja e kapi për krahu.

— Më ngjan s'je mirë! Ndofta u lodhe atje. Bëj durim edhe ca, ja, sikur kemi sosur, — tha Xhezoja me një zë të ngrohtë prej babai, duke i rregulluar gunën supeve.

— Sa do fshati akoma? — pyeti partizani me gjysmë zëri, sikur të mos qe ai pak më parë që thërriste e këndonte.

— E ndonjë orë, — tha Lutoja.

— Ç'është ajo orë? As gjysmë jo! Ja vamë! — tha Xhezoja, dhe unë e kuptova që gënjente. — Bëj si të bësh e këtazë rrugë! Të dhemb shumë?

— Më lëshojnë sytë miza e më vjen bota rrotull.

— S'ke faj, ke humbur gjysmën e gjakut, — tha dhimbshëm Tahiri.

— Rri ashtu përmbys e mos e shiko dëborën, se të merr mendtë, — tha Xhezoja prapë me atë sigurinë e njeriut që jeta e ka rrahur, kur i thonë, me vaj e me uthull.

Ai i doli partizanit në të majtë dhe ecte përkrah tij. Tahiri i doli në krahun tjetër dhe e vunë në mes. Unë kisha mbetur në fund të karvanit. Më dukej sikur më kishin harruar, sikur për mua s'mendonte më njeri. Kjo sikur më çlironte nga një barrë e rëndë. Le të mos kujtoheshin më për mua dhe të kujdeseshin vetëm për atë, kjo më dukej se ishte gjithçka që mund të bëja për të. Por ai pyeste vazhdimisht për mua. Zërin nuk ia dëgjoja, por e kuptoja këtë, ngaqë Xhezoja e Tahiri kthenin kokën nga unë e i thoshin atij: «Mirë! Mirë!»

Kështu, humbur në mendime, hyra në Ftonjar. Ditën e dasmës lufta dërgoi Beshon krushk në martesën time.

## VIII

Kur u nisëm, doja që kjo rrugë të mos mbaronte kurrë. Më trembte e panjohura që më priste në Ftonjarin e largët. Por, tek shihja që partizani mezi mbahej mbi mushkë, mezi pritja të hynim në fshat.

— Durim dhe ca... Ja, vamë. — thoshte Xhezoja kohë pas kohe, po fshati s'dukej gjëkund.

Më në fund ai na u shfaq fare papritur, pas një kodre të lartë, që dukej si ndonjë mullar pambuku. U dëgjua një e shtënë dhe Beshoja ngriti kokën.

— Arritëm! — tha Tahiri.

Lutoja mbajti kalin ngadalë dhe doli në krahun tim.

— Ngrive? — më tha.

— Jo! — mëmërita unë, por, kur provova të lëvizja duart, pashë që gishtat nuk i urdhëroja dot.

Xhezoja ngau më të djabathtë dhe hymë në një



rrugëz të ngushtë si përrua. Shtëpitë ishin rreshtuar në të dyja anët e saj. Njerëzit ishin vargosur pas portave e gardheve. Na buzëqeshnin, na përshëndetnin, na uronin. Më ngrohnin me fjalët dhe shikimet. Fytyrat e tyre më dukeshin të njohura e të dashura. Dikush zuri për freri kalin tim. Të tjerët qëndruan pas meje, dhe ai e hoqi karvanin nëpër një portë të madhe hapur dy kanatash. Papritur u bëra përsëri vajza e humbur e Humbëtirës. Më mbërthyen befaz një palë ethe të forta. Duart e këmbët nuk i urdhëroja dot, nuk dëgjoja asgjë. Turfulloja e gjitha, sa edhe frymë mezi merrja duke dihatur.

Sytë e të gjithëve kishin mbetur te dera e një konaku të vogël, që dukej si lungë e shtëpisë dykateshe, dhe pritnin në heshtje. Ata më të paduruarit i shkulnin hera-herës sytë që andej dhe i hidhnin sa tek unë te Beshoja, të cilin Xhezoja e Tahiri po e zbritnin me kujdes nga mushka. Kali im, që e mbanin akoma për frerësh dy të panjohur, shkrofëtinte dhe lëshonte shtëllunga të trasha avulli. Te dera e konakut të vogël u duk një plak i gjatë e i kërrusur, që e mbanin për krahësh dy burra. Gratë ia nisën këngës:

*Erdhi nusja, e bardha, e bardha,  
E ëmbla si dardha, si dardha!  
Erdhi nusja, e holla, e holla,  
E ëmbla si molla, si molla!*

Disa qeshnin nën buzë me Beshon. Si duket e kishin marrë për ndonjë nga njerëzit e mi, që ishte dehur e kishte ardhur të më shoqëronte. Edhe plaku e vërejtí një çast nën vetullat e bardha, pastaj Xhe-

zoja diç i pëshpëriti në vesh dhe ai urdhëroi të pushonte kënga. I hapi rrugën partizanit që po e futnin për krahësh në konak dhe u çapit pas tij.

— Edhe nusen këtu silleni, — tha plaku.

Pushteti i tij në dasmën time ishte i padiskutueshëm. Vajzat e nuset e reja, që mbushnin obrin, u prishën në fytyrë. Ato mezi kishin prituri të fillonin ato ceremonitë e zakonshme të pritjes së nuses, që më dukej se s'do të mbaronin kurrë, por plaku, me një fjalë, i preu të gjitha. As që vura re kush më zbriti nga kali, veç kur pashë që një grua e shëndoshë ballabane dhe një vajzë e re më futën krahët e po më shpinin atje ku kishte urdhëruar im vjehërr. Graria na ndiqnin pas dhe çuquritnin të pakënaqura nën një napë të hollë trishtimi. Si më futën edhe mua në konakun e zjarrit, plaku urdhëroi të mbyllnin derën. Partizanin e kishin shtrirë pas vatrës dhe po i hiqnin çizmet. Plaku që përkulur i tëri mbi të dhe i kishte vënë të dyja duart mbi ballë. Unë isha bërë mermer në mes të dhomës, midis vjehërrës e kunatës, që gjithashtu shikonin të huturara të panjohurin.

— Hë, moj, vulëhumbura! Ç'më shastisni edhe ju kështu! — tha nervoz vjehërr. — Qaseni nusen pas zjarrit. Nuk shikoni që është kallkanosur?

Ai u përkul prapë mbi Beshon e seç i thoshte me një zë të dridhur e si përkëdhelës, po partizani ishte si në agoni dhe kishte dhembje të forta kur i hiqnin çizmet.

Gratë, aty pas derës, nisën një këngë që s'e kisha dëgjuar kurrë, në fillim si duke mërmëritur, por dalngadalë kënga mbuloi gjithçka.

— Thuajuni atyre të mbyllin grykën se dola t'u



futem vitheve me stap, — u nxeh plaku, por, pa mbaruar akoma fjalën, kënga u këput njëherësh.

Më në fund Beshos ia hoqën edhe çizmen e këmbës së plagosur. Sado që e patëm shtrënguar plagën, ajo pat rrjedhur përsëri, dhe, nga gjaku i trashë që u derdh nga çizmjja, aty pas vatrës u bë një pellg i vogël, sikur të kishin therur një bagëti.

— Lëvizni, moj, de! Oj po duarthara që janë! Po s'i shpove, s'tunden. Ujë të ngrohtë, de, raki, lecka të pastra... — thërriste plaku, pa iu drejtuar askujt, dhe gjithçka bëhej gati në çast.

Beshos ia zgjidhën këmbën me kujdes, ia lanë plagën me ujë të ngrohtë, që mori në fillim një ngjyrë trandafili, pastaj u bë dhe ai i kuq si gjaku. Këmbën tjetër ia kishin afruar te zjarri dhe e fërkonin duart e forta të Xhezos. Unë shikoja si e shastisur fytyrën e merakosur të vjehrrit, që ishte përkulur mbi Beshon e mezi mbushej me frymë, dhe trupi as që ma ndiente të ngrohtët e zjarrit. Pastaj, Xhezoja i tregoi si e kishim gjetur partizanin, ç'na kish-te ndodhur rrugës dhe merakun e tij për të vajtur patjetër diku gjer në mesnatë.

— Si qenke bërë, o bir! S'të paska mbetur gjak në trup... — psherëtiu plaku. — Po do t'ia hamë t'ëmën këtij kodosh gjermani, do t'ia hamë!

Vjehri im kishte ndryshuar shumë, ishte tretur e plakur njëherësh e më dukej sikur s'qe ai që pat ardhur një vit më parë në shtëpinë tonë për të marrë dhitë. Tek shihte i vrerosur plagën e Beshos, humbiste edhe më e, të qe ndonjë që të mos e dinte se qe Nurja, zor se e njihte.

U nder një heshtje e rëndë, e lodhshme dhe e papërshkueshme nga shikimet. Plaku u përkul mbi plagën e Beshos, thua se do ta puthte, dhe i frynte

duke mbledhur buzët e plasaritura e si të zbardhura nga ethet.

— Kruani rripat! — tha si gjithmonë, pa iu drejtuar askujt, dhe i këputi prapë një të sharë vendshe gjermanit.

Ç'qenë burra aty, hoqën rripat e mesit. Njërin skaj e zinin me të dyja këmbët, kurse tjetrin e shtrëngonin nën mjekër dhe filluan t'i kruanin me thikat e mesit, duke nxjerrë një push të hollë ngjyrë tjegulle. Unë shikoja këmbën e Beshos, e cila, rreth asaj njollës së kuqe që bulonte gjak, kishte marrë një ngjyrë të zbetë, midis së verdhës e grisë. Tahiri mbushi një grusht të mirë me pushin që ishte krojtur nga rripat dhe ia dha plakut, por ai ia lëshoi përsëri në dorë.

— Na, s'më bëjnë duart mua... Pllakosja mirë mbi plagë... Po dale, prit njëherë... Leckat.

— Këtu i kam! — tha vjehrra, që rrinte e gatshme pas shpinës së tij.

— Pllakosja mirë, — tha plaku përsëri. — Të mos marrë frymë plaga... Ashtu de, shtrëngoje... Leckat, moj! Shtrëngoja shumë... Shih djalli, shih! Po jo, moj, ashtu, de... Kush ia kishte lidhur rrugës?

— Nusja, — tha Xhezoja.

— Hiq andej, — i shfryu plaku së shoqes. — Është plagë plumbi kjo e do shtrënguar, s'është plagë gjembi. Ç'më taranitesh? Ky është burrë e duron. Hajde, moj bijë, këtu ti... A të shkrinë duart?

Iu afrova ngadalë e me një hap të pasigurt.

— Lidhja ashtu, si ia pate lidhur rrugës, veç shtrëngoja ca më shumë.

E mblodha veten dhe s'më turbullonin më as të panjohurit e as shikimet e tyre, që ndiqnin duart e mia. Plaku ishte përkulur tok me mua dhe diç më



mërmëriste rrëzë veshit. Zëri i tij më vinte i ngroh-të, i dashur, përkëdhelës. Por unë isha mësuar ndryshe, isha rritur ndryshe, atje te ne burrat flitnin ashpër, jepnin vetëm urdhra e porosi, shanin e qor-tonin. Kohët e fundit edhe babai sikur kishte zënë të zbutej, po këtej burrat ishin më ndryshe, më të urtë, më të butë, më të çelur.

Si mbarova së lidhuri plagën, plaku më uroi, kurse partizani u ngrit ndenjtur, me gjithë kundër-shtimet e vjehrrit e të Xhezos. Dhe vetëm atëherë vura re sa e tretur dhe e zverdhur që fytyra e tij.

— Epo ç'më rrinin kështu, de! Këmbëthara gra këto, të mos kesh parë... — grindej plaku. — Sill-ni, moj, ndonjë gjë të ngrohtë për të ngrënë. Këtij i është ngjitur barku pas kurrizit, këto më rrinë!

Vjehrra dhe kunata ime u zhdukën pa fjalë dhe u kthyen pas pak me një tepsi të madhe, ku kishin vënë mish të zier, disa copa byrek dhe specat të mbu-shur me gjizë.

— Po shishen, ku e keni? — tha plaku.

Ia sollën menjëherë, me gjithë një gotë të vo-gël. Ai e mbushi dhe e futi shishen në prehër.

— Epo gëzuar, o trim, e mirë se më erdhe!

— Më solli lufta, xhaxha!... S'm'u ndanë këta djemtë e tu!... Më falni, se ju trazova e ju prisha dasmën.

— Kapedan, atë fjalë mos ia thuaj më Nures, se prishemi. Ti je partizan e, ndodhi si ndodhi, je mik në shtëpinë time. Bash i miqve. Tani që m'u bëre dhe krushk i djalit, të kam dy herë mik. Hajd, gëzuar! — Plaku e ngriti me fund e pastaj ia mbushi gotën partizanit.

— Mbaje, djalë! Rakinë e kemi të mirë, nuk të prish.

— E, ç'ju ngatërrova punët, — tha i mërzhitur Beshoja.

— Të thashë, atë fjalë mos ta dëgjoj më, se të zemërohem, për kokë të djemve, dhe inatin e kam të hidhur. Ja, kështu. Ngreje!

— Të trashëgohet Ganiu, xhaxha, e me një qilirim së shpejti.

— Hë, më të lumtë goja, de! Pije, trim i xhaxhait! Me shëndet! Gjak e dhjamë!

Partizani e hodhi rakinë njëherësh. Iu mbushën sytë dhe e mbyti kolla.

— Ha! — tha plaku. — Je telendisur fare.

Beshoja mori me zor katër-pesë kafshata, sa të mos i prishte qejfin të zotit të shtëpisë dhe u ngrit me kujdes, duke u munduar të mos e trazonte dhembjen. U mbajt një çast pas oxhakut dhe, kur u sigurua se e mbanin këmbët, e hoqi dorën ngadalë dhe i qeshi buza. Ishte një buzëqeshje e kthjellët, gati-gati fëmijnore, që zbulonte një gëzim të madh, të fshehtë.

— Ç'u ngrite? — tha plaku. — Mos ke nevojë për gjë? Sonte do të rrish këtu, s'je për rrugë.

— Të falem nderit shumë, xha Nure, po nuk rri dot. S'më pret puna. Edhe kaq që ndenja, kam frikë se do të vonohem e pastaj e mori lumi. Veç një lutje kam: në ditshi, më tregoni ndonjë rrugë, që pret më shkurt për në Goricë.

— M'i tha Xhezua të gjitha, m'i tha. Ti ke hak të merakosesh, kështu e kanë këto punët tuaja. Po unë kam djem e nipër plot dhe ta mbaroj këtë punë, mos ki dert. Me Partinë i kam të gjithë e çoj marrin erë edhe nga këto punërat e luftës. Ta shpien amanetin në vend sikur të ishe vetë. Rri sonte këtu.



— Ju bëtë tepër, dhe unë s'do t'ju harroj kurrë...  
Po nuk mundem. Do të shkoj patjetër. Veç letrës,  
kam edhe ca porosi gojarisht për komandantin.

— Të marr vesh... Dhe ke hak! Po moti është  
mos më keq e ti je sfilitur fare. Zemra ma do të të  
mbaj, po ju të malit dini ca më tepër e unë s'të dal  
dot përpara. Do të shkosh me një nga djemtë.

— Falemnderit xhaxha po më falni se paski dhe  
dasmë e ju trazova.

— Ç'dasmëzezë! Dasmë është kjo juaja, kjo e  
madhja, juaja e jona tok.

Beshoja filloi të rregullohej. Ata që ishin bren-  
da, shikonin njëri-tjetrin e sikur i thoshin partiza-  
nit të zgjidhte njërin prej tyre.

— Do të shkojmë tok, — tha Xhezoja.

— Ju futa në belara, — tha partizani.

— Do të shkojmë të dy, — tha Tahiri dhe u  
ngrit. — Të shpie unë gjer në vend.

— Jo! — tha prerë Ganiu. — As ti e as Xhe-  
zua. Do të shkoj unë.

— Mirë e ka — u hodh plaku. — Atë po men-  
doja dhe unë.

— Nuk shkon kjo punë, — tha Lutoja. — Më mi-  
rë të nisem unë.

— Jo, de, jo! — tha plaku. — E di që e shpini  
të gjithë, po Ganiu është më i sigurt. Punë me zarar  
këto të Partisë, s'bëhen shakara. Janë koka njerëzish  
atje në Goricë, s'janë kunguj. Ganiu ndryshe, e ka  
bërë kaq herë këtë rrugë. Ndaj e kanë vënë edhe si  
korrier... Edhe ata të komandës i njeh. Sido që të  
vejë puna... Se luftë është kjo e shkretë... Apo e  
kam gabim, o kapedan? — i tha partizanit, sikur  
t'i kërkonte të falur që po i kujtonte vdekjen

— Të ishte ca më i ri, me siguri do të ishte bërë

komandant, — tha Beshoja. — Megjithëse edhe këtu komandoke mirë.

Ai që e quanin Gani, gjithë kohën kishte qëndruar pas meje, dhe unë s'e kisha vënë re. Kur plaku zuri emrin e tij në gojë, dhe ai doli të pregatiste hajanët për rrugë, pashë një palë shpatulla të gjera, sa mezi e nxinte dera, një zverk të bëshëm dhe flokët e dredhur e të zinj si pendët e korbit. Goditja ishte e beftë dhe e fuqishme. M'u errën sytë dhe sikur po më merrej fryma. Ishte ai... im shoq. Kishte qëndruar një orë të tërë pas kurrizit tim, dhe mua s'më kishte shkuar ndër mend se mund ta kisha kaq pranë. Mbas pak Ganiu hyri përsëri dhe foli që nga dera:

— Kuajt janë gati.

— Epo, më jep leje, xha Nure. Djali me trashëgim e më falni që...

— Rrugë të mbarë e me faqe të bardhë! — ia preu fjalën plaku. — Gani, kot të të porosit, ti ma di kokën.

Djali uli kryet dhe vetëm atë çast i hodha një vështrim kalimthi, por s'ia pashë dot fytyrën.

— Bjerini nga Shurrigat — tha plaku. — Veç hapni sytë andej nga gryka. Dëbora është hileqare e të gënjen. Epo, toke me plakun, kapedan.

Beshoja u puth me plakun e u përçafua me të tjerët. Mua më mori dorën në mes të duarve të tij.

— Si të quajnë? — më pyeti, ndërsa sytë e tij më lanin me një rrëke dashurie.

Më ishte tharë goja e s'mund të flitja.

— Bele! — u përgjigj plaku për mua.

— Ç'vëllezër ke?

— Njëzë të vetëm! — tha prapë plaku. — Mund ta gjesh andej nga do vesh.



— Tani do të kesh dy, — tha Beshoja. — Të kam motër, Bele!

Më vinte çudi, kur dëgjoja emrin tim. Pata kujtuar se ai do të mbetej atje në Humbëtirë, bashkë me vajzërinë time dhe këtu do të më thërritnin të gjithë *nuse*. Kurse këtu më thërritnin në emër.

Ai rrëmoi një çast rreth mesit dhe nxori që andej ca fishekë.

— S'kam ç'të të jap tjetër. Ky ballë fishekë m'u ndodh me vete. Merri sa për shenjë, — dhe m'i lëshoi në dorë.

— Mbaji, se mund të të duhen rrugës, — tha Xhezoja.

— Merri, bijë, merri, — u hodh plaku. — Këtë e kemi më të mirin e peshqesheve, pa fishekë i jap unë këtij trimit, sa të dojë. I mbush një torbë. — Dhe iu kthye partizanit: — Ma bëre qejfin. Qenke tamam nga të Partisë!

U ngrit ngadalë, duke u mbajtur pas murit dhe e puthi Beshon.

— Dhe, sa herë të të bjerë rruga këtej, të më kthehesh në shtëpi. More vesh? Në mos qofsha unë, janë djemtë. Të vish si në shtëpinë tënde. Kisha dy djem e u bëra me tre. Hajde, me faqe të bardhë e u pjekshim së shpejti në Shqipërinë e lirë.

— Po dhëndrin s'e pashë, — tha partizani Besho, — ta uroja.

Ganiu uli kokën përsëri.

— Nisuni se kenë për të bërë nja tre sahat udhë, pa ke kohë ta urosh, — tha Xhezoja.

Beshoja shtangu. Kishte harruar që dhëndrin e quanin Gani.

— Kjo nuk vete fare, — iu ankua plakut. — Djali martohet, kurse ju...

— Ti the dhe vetë, këtu jam unë kumandar, —  
tha prerë plaku. — Silljani pushkën dhe jepini gunën  
time.

Për herë të parë m'u duk sikur edhe Beshoja e  
humbi e s'dinte ç'të thoshte. Dolën të gjithë në oborr.  
Veç unë kisha mbetur më këmbë në mes të dhomës  
dhe plaku, që ishte mbështetur te dera e hapur. Ka-  
lin, ku do të hipte Beshoja, e kishin rrethuar me  
katër fenerë. Pas tyre qenë qarkuar dasmorët. Xhe-  
zoja e Tahiri e vendosën atë mbi samar dhe e mbësh-  
tollën me gunën e dhirtë të plakut.

— Ua mbushët torbën me të ngrëna? — pyeti  
plaku.

— Këtu në samar e kanë, — tha Xhezoja.

— Gani, — thirri plaku, kur i biri po matej t'i  
hipte kalit.

— Urdhëro, baba! — u përgjigj djali dhe iu  
afrua.

— Dëgjo, po i ndodhi gjë atij, të mos më vish  
i gjallë.

— Mos ki merak, — tha djali i sigurt dhe m'i  
nguli sytë.

— Toke me nusen. S'dihet! — i tha plaku,  
pasi e përqafoi. Ai e shihte të birin çuditërisht me  
ngulm në bebëz të syrit dhe më dukej sikur i dri-  
dhej mjekra.

Ganiu më shtrëngoi dorën, por unë nuk pashë  
asgjë. M'u morën mendtë dhe më vinte dhoma vër-  
dallë. U kapa fort pas diçkaje të fortë e të ftohtë,  
gjersa ndjeva dhembje në kockë. Hapa sytë dhe pa-  
shë në duar fishekët që më kishte dhënë partizani.  
Iu afrova dritares, po dy kalorësit kishin humbur  
nëpër natën e bardhë. Njerëzit u kthyen përsëri në



dhomë, e fytyrat e tyre m'u dukën të trishtuara. Vjehrra ngashërehej dhe mezi mbante lotët.

— Ç'ke që qurravitesh! — shfryu plaku. — Hajd, shkoni matanë e nisni dasmën. Nusja është e lodhur e mos e mundoni shumë, se ju, graria, jeni ca si noksan nga mendtë. Ulu, o Xhezo, të hedhim nga njëzë!

— Bele, hajde shkojmë lart, — më foli dikush.

Përsëri emri im! M'u duk sikur atë ma kishte dhuruar partizani Besho bashkë me fishekët që s'i lëshoja nga dora.

— Shko, bijë, shko, — tha vjehrrri, duke më rënë shpatullave me dashuri.

Më shungullonte gjaku. U nisa të dilja me një shpresë të turbullt se do të shihja përsëri atë që më shtrëngoi dorën dhe që s'guxova ta shihja në sy, ndonëse ky mund të më mbetej një merak i përjetshëm.

— Nuse, pa dale njëherë... Hajde! — tha befas vjehrrri.

Ishte tepër i shqetësuar. Sytë e tij, që kishin qenë të butë si mëndafsh fëshfëritës, kur i mjekonim plagën partizanit, tani i turbullonte një shqetësim i përmbajtur, që e bënte dhe zërin e tij të dridhej.

— Rri! — tha plaku dhe u tërhoq mënjanë që të ulesha pranë tij.

Që kur isha nisur nga shtëpia ime, e dija se disa ditë do të më duhej të rrija më këmbë e të nusëroja si një kërcu, po zëri i tij ishte urdhërues, dhe unë u ula më gjunjë pranë tij, e druajtur, sikur po bëja një turp. Dasma ime po nxirrte shumë të papritura.

— Dëgjo, çupë e babait! — tha vjehrrri, duke më hedhur dorën supeve. — Kam një merak e dua të ta them, se s'ma mban xhani. Dasmën, siç e di, e patëm lënë për nga behari e mezi ia mbusha mendjen tët eti për të të marrë tani. Po punët e luftës kështu e

kanë... Ganua duhet të ikë në mal. Kështu, thonë, qenka urdhri. Ata e dinë e unë s'hyj t'i pyes për këto punë. Ndaj të mora tani. Ta fut nusen në shtëpi, thashë, pastaj le të shkojë Ganua. Do zoti edhe ndonjë djalë...

Digjesha e tëra dhe më buçitnin veshët, kur dëgjoja zërin e tij.

— Ndofta s'bëra mirë... — Ai e ndiente veten ngushtë dhe kruante zverkun. — S'desha të hyja në gjynah, ndaj t'i thashë ato fjalë. Sonte po siç e pe... Keq më erdhi, sa unë e di, po puna që me zarar e djali duhet të shkonte se s'bën. Mbase të kam hyrë në hak, po pleq ne, rroitim nganjëherë. Ma bëj hallall!

Vjehri më kërkonte ndjesë për ikjen e burrit tim. Kjo ishte e pabesueshme, diçka që nuk e kapja dot as nëpër atë dritë të re, që po ndizte ajo ditë e çuditshme në sytë e mi.

— Po ai do të vijë, çupë e babait. Do të vijë e dasmën do ta bëjmë dasmë. Ai s'ma ka prishur kurrë. Ti e pe si e porosita. Do shpjerë partizanin e do vijë, mos u mërzit.

Ai kishte ngritur zërin dhe mendohej të tregohet i sigurt në ato që thoshte, jo aq për të më qetësuar mua, sesa për të mbytur një dyshim të fshehtë, që e brente diku në thellësitë e tij e që, me siguri, do të fyhej keq, sikur të merrte vesh se ia kishin kuptuar të tjerët.

— Bele, hajde, çupë, të shkojmë lart, — tha vjehrra, që kishte mbetur e heshtur në mes të dhomës, me duar të lidhura mbi bark.

«Kështu do të bëhem edhe unë, — mendova dhe e ndjeva veten grua atë çast. — Do t'ia blej mendjen tim shoqi pa hapur gojën. Ata ndoshta s'e kuptojnë që ne gratë jetojmë brenda tyre.»



## IX

Shtëpia ishte dykatëshe, me katër dhoma. Posh-të, në njërën gatuanin, kurse tjetra ishte e parregu-luar dhe e kishin mbushur me misër të pashkoqur e me zaire për bagëtinë. Më ngjitën lart nëpër një palë shkallë të drunjta, që kërcitnin. S'kisha parë shtëpi me shkallë. Në fshatin tonë ndërtoheshin të gjitha përdhese.

Aty ku më futën, kutërbonte erë duhani. Dho-ma ishte e madhe, mbushur me burra në moshë e disa plaka, që ishin ulur shesh rreth e qark. Një grua më mbante për krahu e më shoqëronte, ndërsa unë përkulesha e u puthja dorën të gjithëve, që nga më i vjetri e gjer te fëmijët, që më ndiqnin pas. Pastaj më shpunë në një qoshe, në mes të grave, dhe unë mbeta qiri më këmbë, pa luajtur as qerpikët e syve, që i kisha ngulur në dysheme dhe çdo dasmori që hynte, i puthja dorën. Sipas zakonit, s'duhet të flitja e të shikoja të tjerët, bile as të luaja nga vendi. Dhe, kur kujtoja orët e nusërimit, me atë ngurrimin e tmerrshëm, urimi që u jepej vajzave: «Të pafsha nu-se!», më dukej si mallëkim.

Në fillim sikur fiksova në kujtesë disa fytyra, pastaj gjithçka humbi formë, u rrumbullakos nën një mjegull të dendur, dhe zërat e tyre më vinin në vesh valë-valë, si ca zhurma të çuditshme shpellash. Kisha rënë në një gjendje ireale dhe jetoja me çuditë e asaj dite, me zhgënjimin e papritur të dasmës sime. Ato çaste shtëpia ime më dukej e largët dhe më përfytyrohej duke u dridhur. I gjallë e i pastër më dilte vetëm babai në çastin e ndarjes, me atë puthjen që i mbeti në buzët e rreshkura pa ma dhë-në dot. Pastaj... udha me krushqit, ai udhëtim tron-

ditës, partizani me emrin e luftës Besho, plaga e tij, fjalët e Xhezos, ballistët, pastaj Ftonjari me atë formë të çuditshme, plaku Nure, vjehri im. Tek më quante bijë, më dukej sikur më përkëdhelte me ato duart e mëdha, të ashpra e të fishkura nga pleqëria e nga sëmundja. E ndieja se kisha filluar ta doja atë burrë bojalli e koskëmadh dhe, sa herë përmendesha e më turbullonte e panjohura e jetës së re, që do të filloja këtu, kapesha pas përfytyrimit të plakut, si për të kërkuar mbrojtjen e tij.

Dikush erdhi dhe më vari diçka në qafë, diçka që më rëndonte e më dukej sikur do të më këputej zverku, ngaqë trupi më ishte tendosur dhe më përqethej nga çdo ngacmim. Një tufë grash kureshtare zgjatën kokat të shikonin stolinë që varej mbi gjoksin tim e që unë vetë nuk e kuptoja ç'qe.

Njerëzit hynin e dilnin pa pushim dhe unë puthja pareshtur duar të argasura burrash e grash dhe humbitja përsëri nëpër atë mjegullirën e befasisë së asaj dite.

Dhe befas shfaqej mbi të gjithë ai... Më lbyreshin sytë e më merreshin mendtë, kur kujtoja atë shikimin që më hodhi te dera, kur do të nisej me partizanin Besho. Më dukej se më kishte buzëqeshur dhe diçka të pakuptueshme më kishin pëshpëritur sytë e tij të zinj e të mëdhenj. Fytyra e tij akoma e papërcaktuar mirë sikur më afrohej e më afrohej pareshtur, dhe trupi im instinktivisht u drodh. Kjo më përmendi dhe vura re se gratë ia kishin marrë këngës:

...O sevda e djalërisë,  
o sevda,  
Shkul themelet e shtëpisë,  
o sevda...



Kënga e grave ishte e lehtë, e druajtur, si nëpër hundë. Ishte më tepër një përpjekje për t'u marrë leje burrave. Por ata, sikur të mos e kishin vënë re këngën, filluan të ngrinin gotat e të uronin me zë të lartë, pastaj ia morën edhe ata këngës, dhe zërat e grave humbën e s'u ndien më.

Burrat këndonin për Luftën. Ishte një këngë e re, e padëgjuar, dhe ata e këndonin ngadalë e me pikëllim, sikur ta kishin aty, ndër këmbë, atë trimin e vrarë. Kënga më sillte përsëri ndër mend partizanin Besho. Kur dhoma mbushej me iso, kënga sikur më nanuriste, po, kur ia merrte Takja, me atë zërin e tij që tundte muret, sikur më shkundte dhe mua. Këmbët më ishin mpirë dhe nuk i ndieja më. Më dukej sikur lëkundesha dhe nga çasti në çast do të bija... Pastaj diçka ndodhi dhe u ngritën të gjithë më këmbë. Në dhomë erdhi Nurja, vjehri im, i zoti i shtëpisë. E mbanin për krahësh Xhezoja e Tahiri. Plaku qëndroi një çast në mes të dhomës, u hodhi një sy të gjithëve dhe u ul pranë zjarrit.

— Mirë se më erdhët e jua paça borxh në dasmë të fëmijëve e të nipërve, — i uroi të gjithë me dorë në zemër. Dhe, ndërsa të tjerët i kthenin urimin një e nga një, ai nxori kutinë e madhe të duhanit e ia hodhi dikujt në prehër. Dorë më dorë, kutia i ra dhomës përqark. Dikush erdhi e më pëshpëriti në vesh që të shkoja e t'i puthja dorën babait. Ishte urdhër. Gjithkush mund të më urdhëronte, edhe foshnja e djepit e unë s'mund t'i kundërshtoja askujt. Kështu më kishin mësuar gratë e Humbëtirës, kështu ishte zakoni i nusërisë. Kisha vetëm një frikë. A do të më shpinin këmbët e mpira deri atje, apo do të bija në mes të dhomës?!

Unë e di si i bëra ato shtatë-tetë hapa deri te

vatra. U përkula dhe i putha dorën babait, por ai çapleu sytë e s'ma lëshonte.

— Po ti qenke kallkanosur, moj e shkretë! — tha i shqetësuar ai. — Bre! Po kur janë të lojtura këto gratë! Ju kripsa mendtë, ju kripsa! Kjo e uruara një natë a dy pa gjumë në shtëpi të t'et nga dasma e nga merak, një ditë të tërë rrugë nëpër gamet e nëpër luftë... E këto ma ngulën aty në qoshë, e dil, o shpirt, të dalësh! Shpjereni, moj, matanë, të ngrohet e të rrijë si njeri. Mjaft lëpiu duart tona. Shpjereni matanë e jepini të hajë çupës. Dhe na shtroni sofrën.

Grave përsëri s'u erdhi mirë, po nuk mund ta kundërshtonin dot. Më futën krahun dhe më zbritën përsëri në dhomën e zjarrit. Më rrethonin me një dashuri e një kujdes të njohur e të tepruar grash, që më bezdiste. Unë kisha hyrë në një botë të re, që më joshte me një forcë të pakuptueshme dhe më pëlqente të më linin vetëm në ato trazimet e mia. Dhe gratë, sikur ta kishin kuptuar këtë, filluan të merreshin me mezetë që përgatitnin dhe shpinin lart në dhomën e burrave, kurse mua më lanë me një nuse dhe më lëshuan përpara tepsinë, që i kishin lëshuar edhe partizanit Besho. Por nuk mund të futja gjë në gojë, dhe stomaku heshtte i bindur dhe i qetë, ndonëse s'kisha ngrënë gjë që një natë më parë. Tani e rijetoja më të gjallë e më konkrete atë çka ndodhi në këtë dhomë, kur erdha në fillim. Sytë e mi nuk kapnin asgjë nga ajo mori grash, që hynin e dilnin me zhurmë. Unë shikoja plakun të merakosur atje, pas zjarrit, këmbën e përgjakur të Beshos dhe... atë, burrin tim, Ganiun... Më dukej sikur ai ishte akoma aty pas meje. Me turp, se mos më kuptonin të tjerët, ngrita sytë nga dera ku ai më



kishte ngulur vështrimin dhe më kishte buzëqeshur. Befas u kujtova se ai ishte nisur në një rrugë nga ndoshta edhe s'mund të kthehej dhe më zuri ngërçi.

Nuk di a më kuptoni, po me mua po ndodhte diçka e jashtëzakonshme, tronditëse... Jetoja gjëra të panjohura. Vitet që kisha kaluar në shtëpinë time, më dukeshin të largëta e të turbullta, veç ato ditët e fundit sikur më ngacmonin nga ca. Më bëhej nganjëherë sikur tërë jetën kisha ecur nëpër gjumë, nëpër ëndrra, nga të cilat isha zgjuar ditën e dasmës sime nëpër atë rrugë të bardhë e të pafund, ku takuam partizanin e plagosur Besho. Dasma nuk ishte më për mua ajo gjullurdia e grave, që shtronin e ngrinin mezero, as dollitë, as këngët, as urimet e njerëzve, as nusërimet e mia! Dasma ime ishte diçka e padukshme, si një dorë e fuqishme, që më kishte shkukur nga Humbëtira dhe më hodhi në një botë tjetër, kur fillova të kuptoja për se rrojnë njerëzit.

## X

Dikush erdhi dhe tha se babai kishte urdhëruar të më shpinin përsëri sipër. Rrethuar nga gratë, u ngjita nëpër shkallët që kërcitnin sikur thyheshin eshtra nën këmbët tona. Burrat ishin qarkuar këmbëkryq pas një sofre të madhe sa një lëmë. Plaku ngriti filxhanin e rakisë.

— Të më trashëgohesh, çupë e babait! Qofsh me jetë e me një stan kalamaj!... Epo, ta pimë për giftin këtë kupë, o miq!... Dhëndrin s'e kemi këtu, po ja ku është nusja.

Zëra të trashë e të hollë, të çjerrë e të butë uronin njëherësh e mua më buçitnin veshët. Me-

gjithatë arrita të kuptoja se mungesa e Ganiut fuste nëpër ata zëra diçka të trishtueshme, që i ngjante ankthit. Gratë shtyheshin dhe zgjatnin kokën te dera. Dikush psherëtiu me ngashërim.

Filluan dollitë e këngët. Unë rrija aty pas zjarrit, pa lëvizur e pa folur, duke u nanuritur nëpër atë përgjumjen time të përgjithshme. Ftonjarakët na qenkëshin të tjerë njerëz, më të ngadalshëm, më të butë, më të qetë. Dalta e Luftës kishte punuar këtu, si dukej, gjer në koskë të njerëzve, kurse atje te ne, në Humbëtirë, mua më dukej sikur sa pat filluar. Këtu Lufta kishte hyrë si diçka e zakonshme, kudo, nëpër biseda, nëpër dollitë, nëpër këngët, në dasmat e në mortet e fshatit. Aty njerëzit flitnin për të vrarët e të plagosurit me një krenari që e mbyste dhimbjen, psherëtimën dhe lotin.

Burrat ngrinin shëndete për djemtë që kishin në mal. E pinin shëndetin për të gjithë me radhë një e nga një, duke uruar prindërit ose të afërmit e tij, ndërsa unë mundohesha të mbaja mend emrat e partizanëve të fshatit. Por ata ishin shumë, njëzet e tre, dhe nuk ua mbaja dot mend emrat. Dy prej tyre ishin vajza. Njëren e quanin Dafinë, tjetrës i thërritnin Like. Këto nuk mund t'i harroja. Dhe, duke parë gratë dhe vajzat dasmore, mundohesha të gjeja bija ose motra të kujt ishin ato të dyja.

Burrat vazhdonin dollitë për të rënë, për Partinë, për Komandantin, për Stalinin, për flamurin...

— Unë do ta ngre dhe një për dhëndrin, xha Nure! — tha dollibashi. — Të na vijë shëndoshë e me faqe të bardhë e të na trashëgohet!

— Më rrofsh, — gjegji plaku. — Shëndoshë të paça, o Seit!



— More, po si shumë po vonohet Ganua?! — tha  
njëri, jo pa shqetësim.

— Rrugë nate, Muço. Rrugë dimri. Rrugë lufte,  
— fliste ngadalë plaku, sikur të bisedonte me vete. —  
Veç t'i dalë mbanë punës, pa si të jetë thënë. Edhe  
në i ndodhtë gjë, hallall i qoftë, — si shokët edhe ai.  
Gazin ia pashë e pishman s'jam... Po pse ti, Shuke,  
tepër e kishe Belulë?! Apo s'ishte floriri i djemve!  
Po e mori ai i shkretë plumb! E mori, ç't'i bësh! Për  
burrat është, fundja. Po s'qenë të zotët për të ruajtur  
vatanë, ç't'i duam djemtë! Dhitë i ruan edhe një  
kalama!

Papritur plaku u gjallërua, fytyrën e tretur ia  
ndezi një afsh i brendshëm, sytë iu bënë më të më-  
dhenj e më të çartë, gjoksi i thatë i hovte nën xha-  
madanin e shajaktë sikur donte të rrihte pleqërinë  
dhe sëmundjen.

— Të kishte ndenjur të paktën sonte me nusen,  
ndryshe... — i pëshpëriti dikujt aty pranë një zë  
i panjohur.

S'e kisha ndier veten më ngushtë. M'u duk sikur  
dikush më këputi kolkën dhe ma hodhi aty, në mes  
të vatrës, ku digjeshin me bubullimë kërcunjt të shën-  
doshë dushku. Kushedi si do të isha bërë në fytyrë!  
Plaku më vuri re dhe më zuri për krahu.

— S'je mirë, çupë, jo! Shko në odën tënde e  
bjer e fli të mbledhësh mendjen.

Ai më drejtohej mua, por urdhrat i zbatuan të  
tjerat që erdhën më morën për krahësh.

— S'do ta presim Ganon a, të bëjmë zakonet? —  
pyeti si nëpër hundë një burrë i vjetër, që i thë-  
rritnin dajko.

— Jo! — tha i vendosur plaku. — Nuk e shikoni

që është bërë meit çupa? Ganiu, po i shkoi rruga mirë, ndaj sabah e kur të vijë... Shpjereni matanë të flerë e të mbledhë koskat, — urdhëroi vjehrrin, kur pa se grave sikur s'u bëhej të më nxirrnin nga dhoma.

Vjehrra kishte mbetur me duar të kryqëzuara në mes të korridorit të ftohtë dhe i dridhej buza. I vinte keq që dasma e të birit po i shkonte kështu, së prapthi. Njerëzit qeshnin e këndonin me gjysmë zemre dhe të gjithë mbanin veshët ngrehur dhe pritnin mos vinte Ganiu. Vjehrra m'i nguli sytë mua dhe më shikonte si me turp, si me frikë, si me lutje. Më erdhi keq për të.

— Luftë, bijë e nënës... luftë! Kështu e kanë këto kohë. Po ti mos ki frikë, Gania do të kthehet! Kështu shkon ai për javë... — më thoshte vjehrra me një zë të dridhur, që pengohej nëpër lotët që i gurgullonin në fyt, dhe më puthi në ballë e në të dyja faqet. Pastaj më puthën me radhë të gjitha gratë e vajzat që qenë aty. Dikush hapi derën e odës përballë. Kalova përmes grave. Sytë e tyre ishin të përbotur. Si kisha hyrë brenda, dikush hoqi derën ngadalë që jashtë, dhe unë mbeta vetëm. Dhoma ndriçohej nga dy qirinjtë të porsandezur, që i kishin vënë te koka e jatakut të shtruar mbi dysheme. Në një qoshe, një bakllava e tërë e pafilluar. Mbi një senduk të gjatë me kapak ishin hapur me radhë ato pesë plaçka që kisha shpurë në pajë.

Kisha mbetur më këmbë në mes të odës, e cila më trembte aq shumë dikur me përfytyrimin e saj në këtë natë të jashtëzakonshme, kur unë nuk do të isha më vajza e Humbëtirës, po nusja e Ftonjarit. Diçka lëvizi nën velenxën që mbulonte jatakun, dhe unë u tremba e mbeta pa frymë. Dhe ja, nga rrobat



më del një kokë e vogël dhe e bukur fëmije që më qeshte. Ishte katër-pesë vjeç, jo më shumë, i shëndetshëm e gazmor. Për herë të parë gjatë asaj dite qesha dhe unë. U ula ngadalë dhe i përkëdhela flokët e ashpër ngjyrë gruri. Ai më kapte dorën e më gëzohej.

— Si të quajnë? — e pyeta.

— Bardhul, po mua më thonë Lulush... Ca më thonë edhe Vesho. Do fle me ty, që të bësh djem. Kështu thoshte nënia. Mua më hodhën vjet edhe në jatakun e nuses së Temos dhe ajo bëri djalë. Po unë atë natë nuk fjeta atje, vetëm sa më rrokullisën mbi jatak. se me nusen fjetei Temja. Ne do flemë tok. Xhaxhi Ganua mbase do të vijë nesër.

— Fli, xhan, se është vonë.

Ai më qeshi përsëri dhe u kthye në krahun tjetër. Por pas një çasti prapë u kthye nga unë.

— Po të bësh djalë, do t'i vësh emrin tim? Apo do t'ia vësh Partizan, si ia vunë djalit të Belulit?

I përkëdhela përsëri flokët, duke i buzëqeshur, dhe, kur e pa që s'kisha ndër mend t'i përgjigjesha, e zuri gjumi me doçkat e vogla nën faqe.

— Fëmijët e luftës! — thashë me vete, duke e soditur një çast të gjatë atë fytyrë të pastër e të shëndetshme dhe më pushtoi befaz një dobësi e parakohshme nëne. Por, si të donin të më thoshin që të mos shkoja nëpër mend gjëra të tilla, mbrapa derës u dëgjuan ca zëra grash. Ato kishin filluar të këndonin, shoqëruar nga tingujt e mbytur të një dajreje.

Isha ulur mbi shtrojet e nusërisë me këmbë nën vete dhe s'lëvizja. Një farë kohe mbajta vesh të dëgjoja ç'thoshte ajo këngë grarishte, por veshi më

kapte vetëm ca fjalë të shkëputura dhe s'lidhja dot asgjë.

Shikimi im herë humbiste, as unë s'e di se ku, e herë sillej nëpër dhomë, sikur kërkonte me ngulm diçka që mungonte. Dhe sytë më mbetën në disa njolla të kuqe mbi velenxën time, të cilën e kishin lënë të palosur mbi një sendyq me lule. Me atë e kishin mbështjellë Beshon mbi samar të mushkës. Ishte gjaku i tij, që kishte hyrë në pajën time, siç kishte hyrë Beshoja, i përherëshëm dhe i pazëvendësueshëm në jetën time. Dhe, duke parë ato njolla, m'u fanit një vorbull, nëpër valët e kuqe të së cilës vërtiteshin me një shpejtësi mendjemarrëse të gjitha ç'më patën ndodhur atë ditë: babai në çastin e ndarjes, udhëtimi nëpër dëborë, Beshoja te mulliri, plaga e tij, fishekët e tij, Ganiu me kaçurrelat e zeza mbi ballë, plaku me sytë e butë e të dashur, gurgullima e lotëve të vjehrrës, këngët që s'pushonin matanë për trimat e vdekur e të gjallë. Mbi një karrige të vjetër pashë fishekët që më pat dhënë Beshoja, vëllai im i ri. I mora dhe fillova t'i sillja nëpër duar ato copëza të ftohta metali.

Gratë nuk po ndiheshin më, po burrat këndonin e thërritnin pa pushim. Dikush ishte dehur dhe kërkonte armë. Përgjova me gjak të ngrirë, po zërat sikur u platitën dhe mendova se të dehurin e kishin **qetësuar**. Po fare befas, në dhomën matanë krisi pushka dhe unë mbeta pa frymë. Pritja të fillonte kuja, kur gjëmuan të qeshurat dhe buçiti me një forcë tronditëse kënga për një trim e për ca armë. Zallahia e dasmës ulej e ngrihej, dhe unë isha lëshuar e pafuqishme në valët e saj.



## XI

Ishte kthyer Ganiu. Njerëzit ishin lodhur, kishin pirë shumë, kishin kënduar shumë dhe pritur shumë. Një krismë pushke sikur i shkundi të gjithë. Njerëzit u bënë të potershëm e të papërmbajtshëm në gëzimin e tyre. Një zë kumbues, pasuar nga isoja e korit të të gjithëve, nisi një këngë për Ganiu dhe për mua. Më zunë përsëri të ngjethurat. Për këtë çast nuset e Humbëtirës më kishin folur me javë të tëra, duke krijuar në mendjen time diçka të mistershme, me të cilën do t'i ngitja edhe unë më pas çupat që do niseshin nuse.

Korridori oshëtiu nga zërat e burrave e të grave. Disa enë u rrëzuan me zhurmë dhe nisi një këngë për mbylljen e dhëndrit me nusen. U ngrita e trembur dhe u drodha si në ethe. Dera u hap. Kisha ulur sytë dhe atë s'e pashë, veç ndjeva si hyri si tufan zhurma e dasmës e u përplas mbi trupin tim.

— Mjaft, de, mjaft! — deshi t'i qetësonte Ganiu dhe mbylli derën.

Mbetëm vetëm. Ai më shihte mua, unë këmbët e mia. Dhe pritja fjalën e tij dhe dorën e tij. Isha larë në djersë dhe sytë më kishin zënë perde. Goja më ishte tharë e më dukej se më mungonte gjuha. Ai u afrua ngadalë dhe më vuri dorën në sup.

— Thashë se do të kishe fjetur! — më tha ngadalë. Edhe zëri i tij m'u duk si i druajtur.

Por unë heshtja dhe ai kot priste përgjigje.

— Kushedi sa je lodhur! — tha prapë ai po me atë zë të druajtur.

Pastaj heshti dhe ai një çast, duke soditur buzagaz Lulushin e vogël, që flinte i qetë. Ndezi një

cigare dhe u ul shesh mbi shtrojet. Tani, mendova, do të më thotë edhe mua të ulem.

— Andej takova tët vëlla. Ishte mirë e të bën të fala. Do vijë pas ca ditësh.

Për herë të parë ngrita kokën e guxova ta shikoja drejt e në sy, po këtë herë e kishte ulur kokën ai. Si e hoqi disa herë cigaren, u ngrit dhe m'u afrua përsëri. Më qëndroi përballë. Pastaj dora e tij zuri gushën time dhe më ngriti kokën.

— Ti paske qejf të nusërosh, më duket, — dhe më mori nga duart fishekët që më pat dhuruar partizani. — Yt vëlla më tha të t'i bëj gjerdan e të t'i var në qafë, — qeshi ai. — Kurse unë do të të mësoj të shtiesh me pushkë.

Prapë lufta! S'e pata menduar se mund të hynte deri këtu, ku qe shtruar jataku i nusërisë.

— Bele! — pëshpëriti Ganiu.

Unë u skuqa, sa më dogjën veshët.

— Bele! — tha prapë ai dhe më hodhi krahun supeve. — A dalim jashtë? Ka filluar të zbardhë. Dasma s'është prishur akoma. Si thua, dalim?

Dhe unë, statuja e akullt, shkrija dhe u bëra njeri, njeri që kisha ecur nga Humbëtira në Ftonjar nëpër rrugët e luftës, me njerëzit e saj, të cilët më kishin dhënë të gjithë diçka prej shpirtit të tyre.

— Si thua, Bele? Apo je e lodhur dhe të flihet? — më tha Ganiu përsëri.

U pamë një çast në sy, pa ditur ç'të thoshim. Ai më buzëqeshte pa pushim dhe më ledhatonte flokët, ndërsa dora i dridhej lehtë.

Papritur isha përtërirë dhe më vlonin forca e dëshira që s'i pata njohur kurrë. Ku vajti lodhja, pagjumësia e kaq netve, ajo turbullirë magjepsëse dhe tronditëse, që më muntoi aq shumë? Nuk isha



më çupa e Humbëtirës. Shtigjet e reja që më hapte dita e dasmës, më tërhiqnin me një forcë të papërmbajtshme, po desha një njeri që të më jepte dorën, sa për të hedhur hapat e para. Ndaj e dashurova Ganiun që natën e parë, dhe më duket sikur jemi njohur që kur kemi lindur.

Dolëm në oborrin e bardhë dhe më rrahu fytyrën puhiza e freskët e ditës së re, që kishte filluar të fekste nga majëmalet. Ganiu mbushi duart me dëborë dhe ma hodhi mbi kokë, por unë as që e ndjeva të ftohtët. Isha zjarr e gjitha dhe mund të shkrija një mal të tërë prej akulli.

---